# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5610
E mërkurë, 24 tetor 2018
çmimi 0.40 €


## GAP-i rekomandon uljen e numrit të ministrive në 13 sosh

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE" DEKANJA E FAKULTETIT TË FILOLOGJISË, LINDITA RUGOVA FAQE 4-5

# Pranimi i revistës së Seminarit për Gjuhën në EBSCO, rezultat i një pune të madhe



Dekanja e Fakultetit të Filologjisë, Lindita Rugova, është shprehur e lumtur që ka arritur që revistën e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare ta bëjë pjesë të platformës më prestigjioze të revistave shkencore EBSCO. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka treguar se për ta arritur këtë synim është dashur shumë punë dhe angazhim. Rugova ka bërë me dije se pranimi i kësaj reviste në EBSCO do të ndikojë në ngritjen e UP-së në renglistat botërore, si dhe albanologjia do të depërtojë në botë pa asnjë shpenzim shtesë. Në këtë intervistë Rugova ka folur edhe për fillimin e vitit të ri akademik në Fakultetin e Filologjisë. Ajo ka theksuar se fakulteti që drejton ka nevojë për më shumë salla të mësimit dhe salla të zhvillimit të aktiviteteve studentore që lidhen me mësimin dhe zhvillimin profesional të studentëve

## AKTUALE

### TË BASHKOHEMI TË GJITHË, TA SHPËTOJMË AGIM BAHTIRIN! F. 12



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

### ISMAILI: LISTA E RE E BARNAVE ESENCIALE DO T'I PËRMBUSHË NEVOJAT E PACIENTËVE F. 6

### NORVEGJIA MBËSHTET SHOQËRINË CIVILE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI ME 1.5 MILION EURO F. 6

## EKONOMI

### PROJEKTLIGJI PËR PAGAT CILËSOHET ANTIKUSHTETUES F. 9

### VESELI: ME BUXHETIN E VITIT TË ARDHSHËM DO TË RRITEN PENSIONET PËR 20 PËR QIND F. 9



## SPORT

### MINISTRI GASHI: GJASHTË MILIONË EURO MË SHUMË PËR SPORT F. 18

### FFK-JA SHPËRNDAU TOPAT PËR KLUBET E SUPERLIGËS DHE LIGËS SË PARË F. 19

# Palmeri konfirmon mbështetjen amerikane për dialogun me Serbinë



Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Metthew Palmer, ua ka konfirmuar liderëve institucionalë të vendit dhe një pjese të opozitës mbështetjen e ShBA-së për dialogun me Serbinë. Gjatë vizitës në Kosovë ai ka vlerësuar të arriturat në Kosovë, duke shprehur përkrahjen e mëtutjeshme të ShBA-së për fuqizimin e shtetit të Kosovës në të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon vendi. Ndërkaq përfaqësuesit vendorë kanë vlerësuar se mbështetja amerikane për Kosovën është jetike në çdo proces FAQE 3

## Limaj: Më 26 nëntor në Pejë mbahet mbledhja e dy qeverive Kosovë - Shqipëri

FAQE 7




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Meta: Pritshmëria e Shqipërisë, shumë e madhe

TIRANË, 23 TETOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, të martën është takuar me presidentin e Austrisë, Alexander Van der Bellen, me të cilin ka zhvilluar bisedime dypalëshe në krye të dy delegacioneve respektive. Në përfundim të këtij takimi Meta zhvilloi një konferencë të përbashkët me homologun austriak. Presidenti Meta ceku ndihmën e Austrisë për Shqipërinë në rrugën drejt integrimit evropian, pritshmëria e së cilës është shumë e madhe. "Falënderoj Austrinë për mbështetjen për rrugën evropiane të Shqipërisë. Marrëdhëniet mes dy vendeve të shkëlqyera. Shqipëria dhe Austria, mike tradicionale e aleate të ngushta. Mirënjohje Austrisë për gjithçka ka bërë që nga krijimi i shtetit modern shqiptar. Çdo 28 Nëntor kujtojmë me mirënjohje për mbështetjen që na ka dhënë Austria. Mirënjohës për ndihmën bujare dhe aleancën solide të Austrisë. Përgëzoj presidentin Van der Bellen për kryesimin e suksesshëm austriak të Presidencës së BE-së. Pritshmëria e Shqipërisë, por edhe e rajonit është shumë e madhe. Po punojmë fort të çelim negociatat e anëtarësimit me BE-në", u shpreh Meta.

Më tej presidenti Meta foli edhe për situatën në rajon, duke vlerësuar pozitivisht votimin në Kuvendin e Maqedonisë pro nismës për ndryshimin e emrit. "Votimi në Kuvendin e Maqedonisë pro nismës për ndryshimet kushtetuese, hap shumë i rëndësishëm Votimi në



Kuvendin e Maqedonisë nxit besimin për anëtarësimin e saj në NATO e BE. Meta: Një rajon më pranë NATO e BE garanton më shumë siguri, paqe dhe stabilitet", tha Meta.

Ministri i Mbrojtjes së Malit të Zi, Predrag Boshkoviq, ka vizituar Kosovën

# Thaçi: Mali i Zi po i kontribuon paqes dhe stabilitetit

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim ministrin e Mbrojtjes së Malit të Zi, Predrag Boshkoviq, me të cilin ka biseduar për marrëdhëniet bilaterale dhe për mënyrat se si ato mund të zgjerohen përmes një bashkëpunimi edhe më të mirë në fushën e sigurisë



PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka pritur ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi, Predrag Boshkoviq. Presidenti Thaçi dhe ministri Boshkoviq kanë biseduar për marrëdhëniet bilaterale dhe për mënyrat se si ato mund të zgjerohen përmes një bashkëpunimi edhe më të mirë në fushën e sigurisë.

Presidenti Thaçi e ka njoftuar ministrin malazias për tri projektligjet e votuara në Kuvendin e Kosovës, të cilat e transformojnë Forcën e Sigurisë së Kosovës në ushtri të Kosovës. "Forca e Sigurisë së Kosovës përmes një procesi gradual do t'i ketë kapacitetet e plota në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare dhe si e tillë do jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe do t'i kontribuojë paqes", ka thënë presidenti Thaçi.

I pari i vendit e ka falënderuar ministrin Boshkoviq për praninë e ushtarëve malazias në kuadër të misionit të KFOR-it në Kosovë që, sipas tij, "Mali i zi po i kontribuon paqes dhe stabilitetit". Po në këtë takim është diskutuar edhe për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili duhet të përfundojë me njohje reciproke.

Kreu i shtetit ka thënë se Mali i Zi është shembull i mirë për Kosovën dhe rajonin në rrugën euroatlantike. Ministri Boshkoviq e ka siguruar presidentin Thaçi për mbështetje të gjithanshme të Malit të Zi, sidomos në procesin e integrimeve euroatlantike.

Presidenti Thaçi ka shtuar se Mali i Zi në këto dy dekada ka marrë vendime të rëndësishme për sigurimin e paqes në rajon.

Ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi e ka pritur në takim edhe kryeministri Ramush Haradinaj.

Kryeministri ka theksuar se përvoja e Malit të Zi, si anëtar i NATO-s, na shërben në rrugën tonë të anëtarësimit në paktin veri-atlantik. "Ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi, Predrag Boshkoviq, e falënderova për përkrahjen dhe gatishmërinë për fuqizimin e partneritetit në fushën e sigurisë, gjithmonë në funksion të stabilitetit dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Me transicionin e FSK-së, Kosova po e përmbyll arkitekturën e vet të sigurisë, si garanci për stabilitet dhe paqe të qëndrueshme edhe në rajon e më gjerë", ka thënë Haradinaj.

# Policia maqedonase mbron deputetët që votuan pro ndryshimeve kushtetuese



SHKUP, 23 TETOR - Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë ka marrë në mbrojtje deputetët e VMRO-DPMNE-së që votuan për ndryshimet kushtetuese. Që nga votimi i 19 tetorit patrulla policore po qëndrojnë në afërsi të shtëpive të shtatë deputetëve ndërsa ata po sigurohen edhe gjatë lëvizjeve jashtë banesave të tyre.

Një vendim i tillë është marrë pas kërcënimeve në rrjetet sociale se "deputetët që do të votonin për ndërrimin e emrit të shtetit do të tradhtonin idealin e atdheut dhe parimet e partisë VMRO-DPMNE, se me asnjë çmim nuk do të mbështesin marrëveshjen kapitulluese me Greqinë".

Por, disa prej deputetëve që votuan ndryshimet kanë thënë se nuk ndihen të rrezikuar, si ish-ministrja e Kulturës, Elizabeta Kançevska dhe Lube Arnaudov thanë se asnjëherë nuk kanë marrë kërcënime për jetën, ndërsa kanë mbrojtur qëndrimin për votimin e ndryshimeve kushtetuese, si "mundësi për të ndërhyrë në përmirësimin e Marrëveshjes për emrin gjatë fazës së paraqitjes së amendamenteve për forcimin e identitetit maqedonas".

Deputetët që votuan ndryshimet akuzohen për ngjarjen e dhunshme në Kuvend më 27 prill një vit më parë, dhe mbështetja e tyre për ndryshimet thuhet të jetë bërë për heqjen e padisë për "tentimvrasje dhe kërcënim terrorist të rendit kushtetues".

## Kryemadhi: PS-ja është kthyer në sekt kriminal

TIRANË, 23 TETOR - Kryetarja e Lidhjes Socialiste për Integrim (LSI) Monika Kryemadhi deklaroi se Rama gjatë këtyre viteve qeverisje ka instaluar në vend krimin. Në një takim me të rinjtë e Vlorës, Kryemadhi tha se sot Partia Socialiste është kthyer në sekt kriminal. "Çdo ditë dhe më shumë mundësitë për të rinjtë bëhen të pakta. Historia sa ka nisur. Në këto vite që qeverisi Rama, instaloi krimin. Vetëm përballë të rinjve, përballë shpresës, nuk mund t'i bëjë dot rezistencë njeri. Kam besimin te të rinjtë, dhe do besoj tek ata. Ne sot kemi një PS që është kthyer në sekt kriminal dhe nuk është vetëm parti. Ndaj duhet të punoni shumë fort si të rinjtë e Vlorës. Çdo angazhimi i juaj do të jetë i rëndësishëm për ju dhe qytetin", ka thënë Monika Kryemadhi.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer, ka vizituar Kosovën

# Palmeri konfirmon mbështetjen amerikane për dialogun me Serbinë

**Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Metthew Palmer, ua ka konfirmuar liderëve institucionalë të vendit dhe një pjese të opozitës mbështetjen e ShBA-së për dialogun me Serbinë. Gjatë vizitës në Kosovë ai ka vlerësuar të arriturat në Kosovë, duke shprehur përkrahjen e mëtutjeshme të ShBA-së për fuqizimin e shtetit të Kosovës në të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon vendi. Ndërkaq përfaqësuesit vendorë kanë vlerësuar se mbështetja amerikane për Kosovën është jetike në çdo proces**

EPOKA E RE Muhamet KOCI



Prishtinë, 23 tetor - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Metthew Palmer, i ka siguruar udhëheqësit institucionalë të Kosovës dhe një pjesë të opozitës, se ShBA-ja mbështet dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Teksa ka takuar në Prishtinë liderët kryesorë të Kosovës veç e veç, zyrtari i lartë amerikan ka vlerësuar se ShBA-ja do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në çdo proces.

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se me zëvendësndihmëssekretarin amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, kanë biseduar për marrëdhëniet bilaterale, për zhvillimet politike në vend, për procesin e integrimeve euroatlantike, për procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, FSK-në dhe dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Presidenti Thaçi e ka falënderuar zyrtarin amerikan për mbështetjen që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i japin popullit dhe shtetit të Kosovës.

Duke folur për fazën e fundit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, presidenti Thaçi ka thënë se pas marrëveshjes ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë është radha e një marrëveshjeje historike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Është momentum i mirë për të arritur një marrëveshje historike, që siguron njohje reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Thaçi, sipas komunikatës së Presidencës.

Ndërsa zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer, ka siguruar presidentin Thaçi se ShBA-ja e mbështet procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Presidenti Thaçi ka theksuar se ShBA-ja mbetet partnerja më strategjike që ka Kosova në rrugëtimin e pandalshëm drejt anëtarësimit euroatlantik. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë rol jetik për të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Sipas komunikatës së Zyrës së kryeministrit, Haradinaj me zëvendësndihmëssekretarin amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, ka biseduar për situatën aktuale në Kosovë dhe rajon, për procesin e transformimit të FSK-së në ushtrinë e Kosovës, për dialogun Kosovë - Serbi, si dhe për aspekte që lidhen me përpjekjet për një unitet ndërinstitucional dhe ndërpartiak rreth dialogut dhe me sundimin e rendit dhe ligjit si dhe proceseve të tjera të rëndësishme të integrimit euroatlantik. "Qytetarët dhe institucionet e Kosovës përherë janë falënderues për ndihmën e gjithanshme që ka dhënë dhe vazhdon të japë ShBA-ja për Kosovën. Kosova është e përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit me ShBA-në në të gjitha fushat. Kemi arritur rezultate të ndjeshme në fushën e sundimit të ligjit dhe, po ashtu, vendi ynë duke e rritur konsolidimin e shtetit nga brenda dhe po e forcon agjendën e vet të integrimit euroatlantik", ka thënë Haradinaj.



Kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se Qeveria e Kosovës është duke punuar për forcimin e sundimit të rendit dhe të ligjit, për zhvillimin ekonomik dhe për hapjen e vendeve të reja të punës të cilat do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies për qytetarët tanë.

Ndërsa Palmer, sipas Zyrës së kryeministrit, ka vlerësuar të arriturat në Kosovë, duke shprehur përkrahjen e mëtutjeshme të ShBA-së për avancimin e agjendës integruese dhe zhvillimore të Kosovës. Sipas tij, ShBA-ja do të vazhdojë ta ndihmojë Kosovën për fuqizimin e shtetit të saj dhe proceset nëpër të cilat po kalon.

Zyrtari i lartë amerikan ka takuar edhe liderin e LDK-së, Isa Mustafa, i cili në takim ka qenë i shoqëruar nga nënkryetarët Agim Veliu dhe Lutfi Haziri si dhe nga kryetari i grupit parlamentar, Avdullah Hoti. Sipas komunikatës së LDK-së, Mustafa ka biseduar me zyrtarin e lartë amerikan për zhvillimet aktuale politike në Kosovë, qëndrimet e LDK-së dhe për përkrahjen e shtetit amerikan për Kosovën. "Kosova do t'ju jetë përherë mirënjohëse për kontributin tuaj të pazëvendësueshëm për popullin dhe shtetin e Kosovës", ka thënë kryetari i LDK-së, Isa Mustafa.

Ndërsa zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer, ka falënderuar kryetarin Mustafa për pritjen, duke inkurajuar LDK-në të ketë rol konstruktiv për zhvillimin e vazhdueshëm të Kosovës. Ai ka shprehur përkrahjen e mëtejshme të ShBA-së për Kosovën në të gjitha fushat.

Flet për "Epokën e re" dekanja e Fakultetit të Filologjisë, Lindita Rugova

# Pranimi i revistës së Seminarit për Gjuhën në EBSCO, rezultat i një pune të madhe



**Dekanja e Fakultetit të Filologjisë, Lindita Rugova, është shprehur e lumtur që ka arritur që revistën e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare ta bëjë pjesë të platformës më prestigjioze të revistave shkencore EBSCO. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka treguar se për ta arritur këtë synim është dashur shumë punë dhe angazhim. Rugova ka bërë me dije se pranimi i kësaj reviste në EBSCO do të ndikojë në ngritjen e UP-së në ranglistat botërore, si dhe albanologjia do të depërtojë në botë pa asnjë shpenzim shtesë. Në këtë intervistë Rugova ka folur edhe për fillimin e vitit të ri akademik në Fakultetin e Filologjisë. Ajo ka theksuar se fakulteti që drejton ka nevojë për më shumë salla të mësimit dhe salla të zhvillimit të aktiviteteve studentore që lidhen me mësimin dhe zhvillimin profesional të studentëve**

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 TETOR - Dekanja e Fakultetit të Filologjisë, Lindita Rugova, është shprehur e lumtur që revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është pranuar në njërën nga platformat më prestigjioze të revistave shkencore EBSCO. Ajo ka bërë me dije se pranimi i kësaj reviste në këtë platformë është rezultat i angazhimit të madh personal dhe vlerës që ka revista e seminarit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rugova ka vlerësuar se suksesi i kësaj reviste do të ndikojë në ngritjen e UP-së në ranglistat botërore. "Natyrisht se ky sukses do të ndikojë në ngritjen e UP-së në ranglistat botërore, por kjo na obligon që ne si Fakultet i Filologjisë të bëjmë më shumë për ngritjen e mëtejme të cilësisë së revistës meqë tashmë jemi në konkurrencë të vazhdueshme me shumë redaksi dhe revista të njohura anembanë botës dhe për ta mbajtur këtë nivel. Nuk bën të ndalemi", ka thënë Rugova.

Në këtë mënyrë ajo ka thënë se albanologjia do të depërtojë në botë pa asnjë shpenzim shtesë. "Ajo që po më gëzon pa masë është se albanologjia do të depërtojë në botë pa asnjë shpenzim shtesë, ndonëse mjaft të pranishme e kemi pasur në studimet gjuhësore, letrare dhe kulturore gjithandej. Besoj shumë se punimet dhe kontributi shkencor i revistës së Seminarit të pranohen edhe nga vetë shtëpia jonë", është shprehur Rugova.

Duke treguar për punën që ka bërë deri në arritjen e këtij qëllimi, ajo ka vlerësuar se cilësia e kësaj reviste ka qenë vendimtare për pranimin e revistës në këtë platformë. "Patjetër se tradita dhe përvoja e vendosur në themele të forta të cilësisë e mbarëvajtjes së Seminarit si një ngjarje e madhe shkencore dhe kulturore ka ndikuar shumë që edhe platformat si EBSCO ta pranojnë këtë revistë si produkt të vetin dhe, ndoshta, edhe fati ynë i mirë që jemi ndër revistat e para të gjuhës, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare (në mos e para, po nuk dua të hipotetizoj) që po depërtojmë në arenën botërore në këtë formë", ka thënë Rugova.

Ajo ka folur edhe për Fakultetin e Filologjisë, duke shtuar se ky fakultet po pranohet partner i barabartë në botë me institucione shumë të rëndësishme në botën akademike. "Bashkëpunimin me rajonin dhe më gjerë e kemi trefishuar dhe pritet që së shpejti të konkurrojmë me programe të studimit të përbashkëta, që do të ofrohen edhe në gjuhën angleze dhe do të mbulohen bashkërisht nga Filologjiku dhe nga universitetet e rajonit që janë treguar të gatshme të bashkëpunojnë në këtë rrafsh (Shkupi, Tirana me dy fakultete: FGjH dhe FHF etj.)", ka thënë Rugova.

**"Epoka e re":** *Pak më shumë se një vit pas marrjes së numrit ISSN, Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është pranuar në njërën nga platformat më prestigjioze të revistave shkencore EBSCO. Çdo të thotë kjo për ju që keni pasur një rol të veçantë në këtë drejtim, pasi kjo u tha edhe nga drejtori i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Rrahman Paçarizi?*

**Rugova:** Pas hyrjes në fuqi të rregullores së re për avancimin e stafit akademik në UP (mars 2018) dhe pas mospërfshirjes së punimeve të botuara në Seminar (meqë konsiderohej libër i konferencave me redaksi ndërkombëtare, ani pse deri në vitin 2016 ishte pranuar nga Senati i UP-së në cilësinë e revistës për albanologji dhe deri në vitin 2016 i tërë stafi i Filologjisë (jo vetëm albanologët) ishin avancuar me punimet e botuara në këtë Seminar, pa përjashtim, si menaxhment diskutuam për mundësinë e indeksimit të revistës së Seminarit në platformat e propozuara nga departamentet dhe nga fakultetet. Numrin e katalogimit ndërkombëtar ISSN tashmë e kishim siguruar nëpërmjet bashkëdrejtorisë së Tiranës dhe ndryshe prej shumë revistave të tjera shkencore kosovare, një problem të tillë e kishim tejkaluar. Pas e-mailave të njëpasnjëshëm, së pari rashë në kontakt me platformën CEEOL (Central and Eastern European Online Library) me seli në Frankfurt am Mein, Gjermani, e cila e mbulon një pjesë të mirë të revistave shkencore dhe kulturore të publikuara në rajonin e Evropës Juglindore. Aty jo vetëm që arrita marrëveshje për regjistrimin e revistës së Seminarit, por e indeksova edhe Filologjinë, revistën e Fakultetit të Filologjisë, e cila tash e tutje do të plasohet në këtë platformë rregullisht.

Disa ditë më pas, pasi që e kisha marrë një e-mail kontaktues nga një zyrtare në Bibliotekën Universitare të Kosovës, i shkrova menjëherë personit përgjegjës të EBSCO-s për Evropë dhe, pas shkëmbimit të disa e-mailave shpjegues dhe detajeve të tjera teknike lidhur me mundësinë e regjistrimit të revistës së Seminarit në EBSCO, diku në fillim të gushtit mora njoftimin që revista e Seminarit e kishte kaluar recensionin ndërkombëtar të cilësisë dhe pritej të kalonte edhe nëpër një filtër: atë të përfshirjes në njërën nga katalogët e tyre online për shkenca humane.

Lajmin për përfshirjen e revistës së Seminarit në platformën EBSCO e morëm të hënën (më 22 tetor) nëpërmjet telefonit dhe e-mail-it, bashkë me e-mail-in e morëm edhe kontratën, e cila do të nënshkruhet nesër dhe do të dërgohet e skanuar.

**"Epoka e re":** *Cilat ishin cilësitë që e bënë këtë revistë të jetë pjesë e EBSCO-s?*

**Rugova:** Tradita e Seminarit e cilësuar nga studiuesit e huaj dhe ata vendorë si forumi më gjithëpërfshirës dhe më cilësor i albanologjisë në botë vazhdon edhe më tutje. Rezultatet e punës hulumtuese gjatë sesioneve shkencore, gjatë referimeve dhe ligjëratave të organizuara enkas për çdo vjet, kanë bërë që kjo revistë mos ta humbë peshën fare, përkundrazi, me një indeksim të tillë si ky i sotmi, ne synojmë ta rrisim vlerën e publikimit në këtë revistë, duke iu përshtatur kushteve të reja të botimit në botën akademike. Por, për të ardhur deri te kjo vlerë që e plasojmë sot dhe mburremi me të, nuk duhet harruar punën e palodhshme të themeluesve, të studiuesve, të studentëve, të profesorëve, të dekanëve dhe të drejtorive të kaluara të Seminarit. Secili ekip e ka lënë gjurmën dhe vulën e vet identifikuese në forma të ndryshme.

**"Epoka e re":** *A keni pasur përkrahje nga institucionet qeveritare që ta mbështesin Revistën e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në ecjet e saj, qoftë edhe në EBSCO?*

**Rugova:** Herë më shumë e herë më pak, edicionet e Seminarit e, bashkë me të, edhe botimet që kanë dalë nga ky Seminar, janë mbështetur kryesisht nga



# Fakulteti i Filologjisë ka nevojë për më shumë salla të mësimit

**"Epoka e re":** *Znj. Rugova, ju jeni edhe dekane e Fakultetit të Filologjisë. Sa keni arritur të përgatiteni për këtë vit të ri akademik dhe cili është bashkëpunimi me universitetet e rajonit?*

**Rugova:** Viti akademik tashmë ka filluar. Kemi mungesë të hapësirave për mësim sepse po e ndajmë ndërtesën me FShMN-në dhe kemi nevojë për më shumë salla të mësimit dhe salla të zhvillimit të aktiviteteve studentore që lidhen me mësimin dhe zhvillimin profesional të studentëve (laboratorë të specializuar dhe salla të leximit). Disa sosh i kemi fituar nëpërmjet projekteve, por vështirësia del te sistemimi i tyre nëpër salla të mësimit. Sivjet kemi investuar shumë për rregullimin e kulmit meqë ishte në gjendje shumë të rëndë. E kemi përmirësuar dukshëm rrjetin e internetit dhe shpresojmë shumë që gjatë vitit kalendarik 2019 ta gëlqerosim objektin në tërësi brenda. Sipas shënimeve që i kam marrë nga bashkëpunë-torët e mi, gjatë vitit të kaluar akademik rreth 100 studentë kanë qenë me bursa Erasmus jashtë vendit, dhjetëra profesorë vizitorë nga universitetet partnere kanë ligjëruar në programe të ndryshme dhe i kemi organizuar shumë konferenca të rëndësishme nëpër departamente të ndryshme. Janë publikuar disa monografi të personelit tonë dhe tashmë brenda dy vjetësh na janë bashkëngjitur edhe 12 anëtarë të rinj të personelit mësimdhënës dhe dy të administratës. Më duhet të theksoj se mungesa e personelit administrativ është ende e pranishme, por po plotësohet dita-ditës. Ligjëruesit e ftuar kanë qenë të shumtë, gjithashtu. Ndonëse në objekt të vjetër e me shumë telashe infrastrukturore, atmosfera e punës është shumë pozitive. Tashmë e kemi aktivizuar Institutin e Gjuhës dhe të Kulturës Italiane, do ta kemi tash e tutje një bashkëpunim me Institutin e Kulturës Italiane në Tiranë dhe shpresoj që së shpejti do ta kemi edhe një mësimdhënës të italishtes në nivel të Fakultetit, pastaj nga 5 nëntori do të fillojë zyrtarisht edhe kursi i parë i kroatishtes në kuadër të bashkëpunimit ndëruniversitar me Zagrebin (edhe i shqipes në Zagreb në Fakultetin e atjeshëm Filozofik), tashmë janë diku rreth 25 të interesuar për këtë kurs dhe profesoresha nga Instituti i gjuhës kroate na vjen të hënën. Kemi filluar ta ofrojmë gjuhën shqipe për studentët e huaj që janë në UP dhe për studentët minoritarë të UP-së, nga partneritetet me universitete evropiane (Berlini, Kopenhaga, Torunji, Poznanji, Frajburgu, Fehta, Nysa, Napoli, Venecie, Praga etj.) kemi përfituar shumë bursa Erasmus+ dhe më e rëndësishmja, numri i bursave është dyfishuar nga viti i kaluar. Më duhet ta theksoj faktin se shumë nga këto bursa janë kanalizuar pikërisht në zhvillimin akademik të doktorantëve tanë nëpërmjet qëndrimit semestral ose vjetor të këtyre kandidatëve në universitetet partnere ose nëpërmjet bashkëpunimit në formë të bashkëmentorimit të tyre. Me projekte të tilla, Filologjiku po pranohet partner i barabartë në botë me institucione shumë të rëndësishme në botën akademike. Bashkëpunimin me rajonin dhe më gjerë e kemi trefishuar dhe pritet që së shpejti të konkurrojmë me programe të studimit të përbashkëta, që do të ofrohen edhe në gjuhën angleze dhe do të mbulohen bashkërisht nga Filologjiku dhe nga universitetet e rajonit që janë treguar të gatshme të bashkëpunojnë në këtë rrafsh (Shkupi, Tirana me dy fakultete: FGjH dhe FHF etj.). Programet e tilla të ofruara në një gjuhë botërore për çështje të rajonit do ta rrisnin numrin e studentëve të huaj që studiojnë në Prishtinë dhe një partneritet i tillë do t'i ndihmonte shumë procesit të ndërkombëtarizimit të UP-së në përgjithësi.

UP-ja, nga MASHT-i dhe nga MKRS-ja. Anëtarësimi në platformat me qasje të hapur (Open Access) nuk kërkojnë ndonjë shpenzim shtesë. Vetëm indeksimi i ardhshëm në platformat e tjera që po i synojmë ka mundësi të na kushtojë më shumë sepse kemi plan ta angazhojmë një person të veçantë që do të merret me mirëmbajtjen e uebfaqes së revistës së Seminarit në kuadër të domenit të Filologjisë.

**"Epoka e re":** *Po për Fakultetin e Filologjisë do të jetë një e arritur pasi mund të jetë revista e parë shkencore nga Kosova që është pranuar në EBSCO.*

**Rugova:** Natyrisht që ky sukses do të ndikojë në ngritjen e UP-së në ranglistat botërore, por kjo na obligon që ne si Filologjik të bëjmë më shumë për ngritjen e mëtejme të cilësisë së revistës meqë tashmë jemi në konkurrencë të vazhdueshme me shumë redaksi dhe revista të njohura anembanë botës dhe për ta mbajtur këtë nivel. Nuk bën të ndalemi. Ajo që po më gëzon pa masë është që albanologjia do të depërtojë në botë pa asnjë shpenzim shtesë, ndonëse mjaft të pranishme e kemi pasur në studimet gjuhësore, letrare dhe kulturore gjithandej. Besoj shumë se punimet dhe kontributi shkencor i revistës së Seminarit të pranohen edhe nga vetë shtëpia jonë.

**"Epoka e re":** *Ju keni përmendur edhe bashkëpunimin që keni pasur në këtë drejtim edhe me Fakultetin Histori-Filologji në Tiranë, nga shkencat filologjike që është pranuar në këtë platformë?*

**Rugova:** Pa ndihmën e ish-bashkëdrejtores, prof. Jubani, ne nuk do ta kishim ISSN-në e revistës, për faktin se Kosova nuk është ende e pranuar në UNESCO. Fati ynë që kemi pasur bashkorganizim të mirë të punëve dhe ia dolëm ta marrim nëpërmjet departamenteve albanologjike të atjeshme.

**"Epoka e re":** *A do të thotë se deri te pranimi në EBSCO i revistës ka qenë shtytje edhe angazhimi i traditës së Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, ku deri më tani janë mbajtur 37 seminare?*

**Rugova:** Patjetër që tradita dhe përvoja e vendosur në themele të forta të cilësisë e mbarëvajtjes së Seminarit si një ngjarje e madhe shkencore dhe kulturore ka ndikuar shumë që edhe platformat si EBSCO ta pranojnë këtë revistë si produkt të vetin dhe, ndoshta, edhe fati ynë i mirë që jemi ndër revistat e para të gjuhës, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare (në mos e para, po nuk dua të hipotetizoj) që po depërtojmë në arenën botërore në këtë formë. Natyrisht, kjo e dyta kërkon shumë angazhim teknik dhe tash që e mësuam rrugën, po i synojmë edhe platformat e tjera të popullarizuara tashmë. Prania e Seminarit dhe e vet albanologjisë në botë është e hershme dhe është e vazhdueshme, e pandërprerë, por tash e ka marrë një formë pak më ndryshe, një mënyrë më të lehtë të komunikimit ndërakademik e shkencor në rrafshin global.

# Ismaili: Lista e re e barnave esenciale do t'i përmbushë nevojat e pacientëve

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka marrë pjesë në tryezën e organizuar nga Instituti Columbus, me temë "Beteja mes listës së dëshirave dhe nevojave të pacientëve". Në këtë tryezë u diskutua për procesin e revidimit të Listës së Barnave Esenciale e cila nuk është bërë nga viti 2012 dhe të cilin Ministria e Shëndetësisë e ka nisur këtë vit.
Në fjalën e tij, ministri Ismaili ka thënë se kjo listë duhet t'i përmbushë nevojat e pacientëve dhe spitaleve e jo të kompanive farmaceutike. "Lista e re e barnave esenciale duhet t'i përmbushë nevojat e pacientëve dhe të spitaleve e jo të jetë një listë e dëshirave dhe nevojave të ndonjë kompanie. Që ky proces shumë i rëndësishëm të realizohet mbi këto standarde, unë kam themeluar Komitetin Teknik për Revidimin e Listës Esenciale, ku janë përfshirë aktorë të shumtë dhe profesionalë, të cilët do ta kenë asistencën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë gjatë gjithë kohës", ka thënë ministri Ismaili.
Më tej, për të shmangur çdo konflikt interesi, ministri Ismaili ka bërë me dije se kanë ftuar edhe Agjencinë Kundër Korrupsionit. "Këtë herë pjesë shumë e rëndësishme e këtij procesi është përfshirja e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Kjo Agjenci është ftuar nga ne. Ajo ka qenë shumë ekspeditive dhe përkrahëse që të kontribuojë dhe monitorojë gjatë tërë kohës secilin hap të këtij procesi, duke filluar që nga hartimi i përbashkët i vendimit, ku është paraparë edhe deklarimi i konfliktit të interesit", ka thënë ai.



Si rezultat final synohet që produktet të cilat do të jenë në listë të jenë gjithmonë në stoqet e institucioneve shëndetësore dhe në shërbim të nevojave të pacientëve.
Synohet të bëhet një listë e produkteve të cilat janë aq esenciale sa t'i përmbushin nevojat kryesore të popullatës dhe të jenë tërë kohën të qasshme dhe me kosto të përballueshme.

# Norvegjia mbështet shoqërinë civile në Kosovë dhe Shqipëri me 1.5 milion euro

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 TETOR - Ambasador i Norvegjisë në Kosovë dhe Shqipëri, Per Strand Sjaastad, dhe drejtori ekzekutiv i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile, Taulant Hoxha, kanë lansuar programin trevjeçar të shoqërisë civile për Shqipëri dhe Kosovë. Me një buxhet të gjithëmbarshëm prej 1.5 milion eurosh, programi financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhohet nga KCSF në partneritet me Partnerët Shqipëri. Qëllimi i programit është ta mbështesë pjesëmarrjen demokratike dhe zhvillimin e një shoqërie civile të fuqishme dhe aktive në Shqipëri dhe Kosovë në këto fusha: 1. Mosdiskriminimi dhe barazia gjinore; 2. Mediat e pavarura; 3. Pakicat dhe grupet e margjinalizuara; 4. Mbrojtja e mjedisit dhe 5. Lufta kundër korrupsionit.
Në fjalën e tij Taulant Hoxha ka theksuar rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e Kosovës dhe mbështetjen që KCSF-ja i ofron këtij sektori për tashmë më shumë se dy dekada. Ai ka treguar se paralelisht me ofrim të njohurive dhe ngritjes së kapaciteteve, KCSF-ja ka pasur rol kyç për përshtatjen dhe maksimizimin e mbështetjes financiare të donatorëve për shoqërinë civile në Kosovë. Hoxha e ka vlerësuar lart vendimin e Norvegjisë për të bashkëpunuar me KCSF-në si vazhdimësi e mbështetjes së tyre shumëvjeçare ndaj shoqërisë civile.




Duke iu drejtuar të pranishmëve, ambasadori Sjaastad ka theksuar se shoqëria civile ka një funksion të rëndësishëm mbikëqyrës në Kosovë dhe Shqipëri dhe është pjesë e mekanizmave të kontrollit në një demokraci të fuqishme. "Jemi të kënaqur që KCSF do ta menaxhojë Fondin norvegjez për OJQ, theksoi ambasadori, dhe shpresojmë se ky Fond do të sigurojë mundësi të reja për ndërtimin e një shoqërie civile të fuqishme, të pavarur dhe me bazë në komunitet në Kosovë dhe Shqipëri", ka thënë ai.
Thirrja e parë për aplikim në kuadër të kësaj skeme është lansuar më 10 tetor të këtij viti dhe afati i fundit për aplikim është më 5 nëntor.

# INDEP-ja: Të mos miratohet ndryshimi dhe plotësimi i ri për automjete

PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) u ka bërë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të mos e votojnë ndryshim-plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete. "Duke përcjellë me vëmendje iniciativën, përmbajtjen dhe pasojat që plotësim-ndryshimi do të sjellë, ne jemi të bindur se votimi i këtij projektligji do ta dëmtojë mjedisin në Kosovë, do t'i dëmtojë përpjekjet për ta përafruar legjislacionin me atë të Bashkimit Evropian dhe do ta rrezikojë sigurinë e qytetarëve në komunikacion. Duke monitoruar tashmë gjashtë vjet punën e Kuvendit të Kosovës, INDEP vlerëson se iniciativa është ndërmarrë pa asnjë analizë në terren të implementimit të ligjit aktual dhe pa të dhëna që mbështesin pretendimet



se këto nene nuk po funksiononin", është thënë në reagimin e INDEP-së.
Ky institut ka njoftuar se ka marrë pjesë në diskutimet gjatë dëgjimit publik në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në lidhje me këtë çështje. "Kemi dhënë alternativat tona për ta reduktuar koston për qytetarët duke rritur sigurinë e duke respektuar rregullat vendore dhe evropiane në fushën e mjedisit. Ky ndryshim-plotësimi i kërkuar nuk është rezultat i një monitorimi shumëpartiak të implementimit të Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete, por i një nisme të pabazuar dhe paargumentuar. Aksidentet me fatalitet kanë shënuar rritje eksponenciale në vitet e fundit. Vjetërsia e veturave lidhet ngushtë me sigurinë në trafik dhe studime të shumta kanë dëshmuar se vjetërsia e veturës prej 15 vjetësh e më tepër shton rrezikun për aksident dhe fatalitet për tri herë. Në kohën kur numri më i madh i vdekjeve tragjike vjen nga komunikacioni, rritja e moshës mesatare të veturave që qarkullojnë në rrugët e Kosovës do të nënkuptojë automatikisht edhe rritje të mëtejme të aksidenteve fatale", thuhet në reagimin e INDEP-së.
Në reagim theksohet se automjetet e vjetra dëmtojnë mjedisin me shkarkimet e ndotësve të dëmshëm si grimcat, monoksidi i karbonit, dyoksidi i sulfurit, dyoksidi i karbonit etj. "Këta ndotës ndikojnë në dëmtimin e kualitetit të ajrit, në rritjen e emisioneve kombëtare të dëmshme për klimën dhe përfundimisht shkatërrojnë shëndetin e popullatës. Kufizimi i vjetërsisë së veturave është një masë e butë që dalëngadalë do të ndikojë në përmirësimin e strukturës së veturave që qarkullojnë në Kosovë. Nëse edhe ky kufizim largohet, ose kufizimi prej dhjetë vjetësh bëhet pesëmbëdhjetë, Kosovën do ta mbulojnë vetura me mekanizma të vjetruar filtrimi dhe me ndotje masive. Për më tepër, Kosova është në fazën e hartimit të Strategjisë për Ndryshimet Klimatike 2019-2028. Kjo nismë ligjore është në kundërshtim të plotë me prioritetet që liston kjo strategji dhe mbi përpjekjet kombëtare për t'i reduktuar emisionet e rrezikshme", është thënë në reagimin e INDEP-së.

Instituti GAP ka publikuar raportin "Buxheti 2018 dhe rekomandimet e Komisionit Evropian"

# GAP-i rekomandon uljen e numrit të ministrive në 13 sosh





Qeveria e Kosovës, për të funksionuar në mënyrë optimale dhe për ta shmangur problemin e shpërndarjes së kompetencave, do të duhej ta ulte numrin e ministrive nga 21 në 13. Kështu është thënë të martën në raportin e Institutit GAP me temë "Buxheti 2018 dhe rekomandimet e Komisionit Evropian". Sipas përllogaritjeve të këtij instituti, nga ulja e numrit të ministrive vetëm nga shpenzimet e pagave, telefonia mobile dhe drekat, buxhetit të Kosovës do t'i kurseheshin rreth 3.2 milionë euro në vit apo 12.9 milionë euro për një mandat qeverisës

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 TETOR - Instituti GAP të martën ka publikuar raportin "Buxheti 2018 dhe rekomandimet e Komisionit Evropian", i cili analizon rekomandimet e Komisionit Evropian për Kosovën karshi ndarjeve buxhetore për vitin 2018. Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se ka pasur rritje të buxhetit për disa institucione për të cilat ka rekomanduar KE-ja, mirëpo kjo rritje mbetet e pamjaftueshme. GAP-i vlerëson se rritja e numrit të ministrive dhe fragmentimi i institucioneve të pavarura ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve rrjedhëse buxhetore, njëkohësisht ka penguar kohezionin në vendimmarrje. Sipas Institutit GAP, Qeveria e Kosovës, për të funksionuar në mënyrë optimale dhe për ta shmangur problemin e shpërndarjes së kompetencave nëpër ministri të ndryshme, do të duhej ta ulte numrin e ministrive nga 21 në 13. "Sipas përllogaritjeve tona, nga kjo ulje e numrit të ministrive vetëm nga shpenzimet e pagave, telefonisë mobile dhe drekave buxhetit të Kosovës do t'i kurseheshin rreth 3.2 milionë euro në vit apo 12.9 milionë euro për një mandat qeverisës prej katër vjetësh", është theksuar në raportin e GAP-it.

Më tutje, në këtë raport është theksuar se buxheti për rend dhe siguri publike është rritur krahasuar me vitin e kaluar mirëpo, sipas GAP-it, duhet buxhet i shtuar për trajnim të prokurorëve dhe gjyqtarëve, financim të strategjisë kundër korrupsionit dhe në përgjithësi rritje e kapaciteteve për luftën ndaj korrupsionit. Sa i përket zhvillimit të tregut dhe arsimit, shpenzimet në arsim dhe hulumtime mbesin ndër më të ulëtat në rajon. "Ka pasur një rritje të buxhetit tek institucionet që merren me zhvillimin e tregut në kuadër të MTI-së, mirëpo buxheti për disa nga këto institucione mbetet i pamjaftueshëm. Në anën tjetër, shqetësues mbetet funksionimi i ZRRE-së për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm. Gjithashtu, përkundër rritjes së buxhetit të Agjencisë së Kosovës për Efiçiencë të Energjisë, ende nuk është themeluar fondi për efiçiencë të energjisë", është thënë në raport.

Me gjithë rritjen e buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë, ndarja e buxhetit për këtë sektor, sipas Institutit GAP, është e pamjaftueshme. "Rreth 40 për qind e shpenzimeve në shëndetësi paguhen nga xhepat e qytetarëve dhe kjo është rreth dyfishi i përqindjes së shpenzimeve të qytetarëve në BE", është theksuar në raport.

Edhe sa iu përket çështjeve sociale, për shkak të rregullimit të dobët ligjor, financimi i shërbimeve sociale nga komunat është i ulët. Kurse sa iu përket çështjeve mjedisore, ka pasur një ngritje të buxhetit, mirëpo Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk i është përgjigjur Institutit GAP nëse ky buxhet është i mjaftueshëm.

Instituti GAP vlerëson se probleme të financimit ka edhe në fushën e medieve dhe statistikave. "Ashtu sikurse në vitet e kaluar, ende nuk është siguruar një formë e qëndrueshme e financimit për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), ndërsa mungesë të buxhetit është cilësuar të kenë edhe Këshilli i Pavarur i Medieve (KPM) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)", është thënë në raportin e GAP-it me titull "Buxheti 2018 dhe rekomandimet e Komisionit Evropian".

# Limaj: Më 26 nëntor në Pejë mbahet mbledhja e dy qeverive Kosovë - Shqipëri



PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka bërë me dije të martën, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, se ka kërkuar nga Shqipëria zbritjen e taksës në rrugën e kombit. Limaj ka thënë se në takimin me përfaqësues të Qeverisë së Shqipërisë, ai në emër të Qeverisë së Kosovës ka paraqitur shqetësimin që taksa është e lartë dhe duhet gjetur mënyra për të zvogëluar, e cila do të ishte në dobi të dy vendeve.

Limaj beson se Shqipëria e ka marrë seriozisht këtë kërkesë dhe pret që ata do të vijnë me qëndrim konkret. Limaj më pas ka bëre me dije se më 26 nëntor në Pejë do të mbahet mbledhja e dy qeverive dhe se po punojnë bashkërisht për temat dhe marrëveshjet që do t'i nënshkruajnë.

Zëvendëskryeministri Limaj ka njoftuar edhe për disa nga marrëveshjet për të cilat pritet të nënshkruhen më 26 nëntor.

# Ministri Lluka, pjesë e forumit të interkonektivitetit ndërmjet vendeve të Ballkanit



PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur në takim shefen e zyrës së Greqisë në Prishtinë, Chryssuola Aliferi, me të cilën kanë diskutuar rreth takimit të përbashkët të vendeve të Ballkanit i cili do të mbahet në Athinë dhe vizitës së sekretarit gjeneral të Zhvillimit Ekonomik të Greqisë në Kosovë. Në fund të muajit nëntor në Athinë të Greqisë do të mbahet forumi i interkonektivitetit ndërmjet vendeve të Ballkanit, në të cilën do të marrë pjesë edhe ministri Lluka. "Është kënaqësi të jesh pjesë e këtij forumi pasi që e shoh si mundësi të mirë që t'i paraqes disa prej mundësive për të investuar në sektorin energjetik dhe atë minerar. Gjithashtu, është një mundësi shumë e mirë që të përforcohen lidhjet ndërmjet Kosovës me vendet e Ballkanit edhe në aspekte të ndryshme, jo vetëm në atë ekonomik", u shpreh ministri Lluka.
Gjithashtu, gjatë muajit nëntor ministri Lluka do ta vizitojë edhe sekretarin gjeneral të Zhvillimit Ekonomik të Greqisë, ku do të diskutojnë rreth sektorit energjetik dhe të shihen mundësitë për investime në këtë sektor.
Ministri Lluka, po ashtu, e informoi Aliferin rreth termocentralit "Kosova e Re" dhe masave të cilat po ndërmerren për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Lluka dhe shefja e zyrës së Greqisë në Prishtinë, Chryssuola Aliferi, janë pajtuar që të vazhdojë bashkëpunimi në planin ekonomik në mes dy vendeve.

## Veseli: Me buxhetin e vitit të ardhshëm do të rriten pensionet për 20 për qind

PRISHTINË, 23 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, së bashku me ministrin e Financave, Bedri Hamza, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Sindikatës së Pensionistëve të Kosovës. Veseli i ka njoftuar përfaqësuesit e kësaj sindikate se me buxhetin e vitit të ardhshëm do të ketë rritje të pensioneve. Ai ka thënë se për pensionet bazike do të ketë 20 për qind rritje, ndërsa për pensionet kontributdhënëse do të ketë 15 për qind rritje. "Ky ishte një premtim dhe marrëveshje që kishim bashkë me partnerët e koalicionit dhe jam i lumtur që kjo po realizohet. Falënderoj kryeministrin Ramush Haradinaj si dhe ministrin Bedri Hamza për kujdesin e veçantë në mbështetje të kësaj kategorie", ka deklaruar Veseli. Po ashtu, Veseli ka deklaruar se kujdesi institucional për pensionistët do të vazhdojë edhe më tutje.





## Hamza: Buxheti për vitin 2019 pritet të jetë rreth 2.3 miliardë euro

PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës të martën është diskutuar edhe për buxhetin e vitit 2019. Me këtë rast, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka bërë me dije se buxheti shtetëror për vitin 2019 pritet të jetë rreth 2.3 miliardë euro. Ai ka thënë se një buxhet i tillë paraqet një rritje të madhe krahasuar me atë të vitit 2018. Po ashtu, Hamza ka vlerësuar se rritja ekonomike e Kosovës ka qenë më e madhja në rajon.

# Projektligji për pagat cilësohet antikushtetues

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi, ka thënë se duhet të balancohen pagat sipas ligjit për të tri pushtetet, atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ndërkaq Sami Kurteshi dhe Shkumbin Demaliaj u zgjodhën përfaqësues të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit për të marrë pjesë në Komisionin për Administratë në kohën kur të shqyrtohet Projektligji për paga

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 23 tetor** - Anëtarët e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit kanë mbajtur të martën mbledhjen e rregullt, në të cilën përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe atij Prokurorial i janë drejtuar këtij komisioni me kërkesën për nivelizimin e pagave ndërmjet tri pushteteve, atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kryesuesi i KGjK-së, Nehat Idrizi, ka thënë se duhet të balancohen pagat sipas ligjit për të tri pushtetet, atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. "Me formë të shkruar i jemi drejtuar Qeverisë dhe kemi shprehur shqetësimin tonë. Nuk ka trajtim të barabartë të tri pushteteve: atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Nëse zbriten pagat, le të zbriten për të gjithë, mirëpo le të jenë të barabarta. Aktualisht neni 4 i Kushtetutës e parasheh një mundësi të tillë", është shprehur Idrizi.

Me të njëjtën kërkesë komisionit i është drejtuar edhe Bahri Hyseni nga Këshilli Prokurorial i Kosovës. "Me rastin e hartimit të Ligjit për paga konsiderojmë se është bërë shkelje kushtetuese pikërisht në nenin 4, ku parashihet ndarja e pushteteve. Është e vërtetë se është barazuar Gjykata Kushtetuese, por në rastin konkret ligji e ka përjashtuar pushtetin e tretë. Kjo bie ndesh me ligjet bazike që i kemi në fuqi. Qeveria e Kosovës ka nxjerrë një vendim përmes të cilit jemi prekur edhe ne si prokurorë dhe gjyqësorë, ku kemi qenë të përjashtuar nga të gjitha pagat. Ne po e kundërshtojmë për faktin se po barazohemi me një pagë të një drejtori të departamenteve të komunave të Kosovës", ka deklaruar Hyseni.

Kurse kryetarja e këtij komisioni, Albulena Haxhiu, ka thënë se komisioni do t'i adresojë këto çështje, derisa ka theksuar përkrahjen e saj për kërkesat e Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor. "Ajo çfarë mund të bëjmë si komision në këtë fazë është t'i adresojmë këto ankesa. Vërejtjet janë me vend. Unë kam kundërshtuar vendimin e Qeverisë për rritje të pagave", është shprehur Haxhiu.

Deputeti i AAK-së, Shkumbin Demaliaj, ka thënë se do t'i mbështesin kërkesat e KPK-së dhe KGjK-së. "Është mirë që ligji ende është në lexim të parë. Nuk do të ketë ndoshta edhe ndonjë pjesë të ndërhyrjes në buxhet, por besoj se edhe ne si anëtarë të komisionit do t'i adresojmë këto çështje", është shprehur Demaliaj.

Deputeti i pavarur, Korab Sejdiu, ka kërkuar nga këto dy institucione të drejtësisë bashkëpunim më të madh me komisionin. Ndërkaq nënkryetari i këtij komisioni, Hajdar Beqa, kërkesën e ka cilësuar të drejtë. "Në momentin që e kemi marrë këtë shkresë në komision ne e kemi trajtuar shumë seriozisht. Kërkesat e juaja janë të drejta. Si PDK e mbështesim dhe nuk do të ketë ulje të pagave", ka thënë Beqa.

Bilall Sherifi nga Nisma për Kosovën ka thënë se e përkrah barazinë e pushteteve dhe është pro uljes së pagave dhe jo rritjes së tyre.

Deputetët Sami Kurteshi dhe Shkumbin Demaliaj u zgjodhën përfaqësues të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit për të marrë pjesë në Komisionin për Administratë në kohën kur të shqyrtohet Projektligji për paga.



# Ura e Balincës përfundon në fund të nëntorit



**Prishtinë, 23 tetor (ER)** - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka inspektuar të martën punimet në urën e Balincës, në autostradën Prishtinë - Pejë, për ta parë nga afër zhvillimin e punimeve në këtë segment rrugor, si dhe për të verifikuar nëse gjithçka po shkon sipas dinamikës së paraparë. Lekaj ka dëgjuar nga banorët e Balincës të gjitha preokupimet që ata i kanë lidhur me këtë projekt, duke i siguruar ata se gjithçka do të bëhet sipas standardeve dhe projektit të paraparë.

Gjatë kësaj vizite Lekaj ka kërkuar nga kompania kontraktuese e cila ka përsipër ndërtimin e kësaj ure, të punojnë në mënyrë korrekte dhe në bazë të specifikacioneve të parapara me kontratë. Pritet që këto punime të përfundojnë në fund të nëntorit dhe ky segment të jetë i gatshëm për lëvizjen e lirë të automjeteve.

# Rregullohen hapësirat publike afër objekteve shkollore në Prizren

PRIZREN, 23 TETOR (ER) - Krahas punimeve që po bëhen në Komunën e Prizrenit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka intervenuar edhe në disa shkolla për ta përmirësuar gjendjen në hapësirat përreth tyre. Kështu, në shkollën "Abdyl Frashëri" në Ortakoll është bërë shtresimi i terrenit sportiv, ndërsa në shkollat speciale "Lef Nosi" dhe "Nënë Tereza" janë nivelizuar oborret dhe hapësirat përreth shkollave.





# Ferizaj afër krijimit të zonës së parë ekonomike

FERIZAJ, 23 TETOR (ER) - Komuna e Ferizajt është shumë afër krijimit të zonës së parë ekonomike. Kjo është një ndër synimet e kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, për ta dhënë kuptimin e plotë, epitetit tashmë të dëshmuar se Komuna e Ferizajt është kryeqyteti i zhvillimit ekonomik në Republikën e Kosovës. Kështu është bërë me dije në njoftimin për media të Komunës së Ferizaj. Zëvendësministri i Financave, njëherësh koordinator për zhvillim ekonomik i Komunës së Ferizajt, Mustafa Grainca, i shoqëruar nga Selim Marevci, shef i kabinetit të kryetarit Agim Aliu, takuan ministrin e Tregtisë dhe Industrisë Endrit Shala me bashkëpunëtoret e tij, me të cilin biseduan lidhur me procesin e krijimit të zonës ekonomike. Ministri Shala u zotua se në një afat rekord do të përmbyllen të gjitha procedurat ligjore lidhur me këtë proces.
Ndërkaq zëvendësministri Grainca ka falënderuar ministrin Shala për gatishmërinë e treguar, në mbështetje të proceseve dhe projekteve që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të Ferizajt.



# Latifi për punën e administratës: Ka pasur progres në respektimin e orarit të punës

RAHOVEC, 23 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur të martën takimin e tretë me punonjësit e administratës, nga të cilët ka kërkuar respektimin e orarit të punës, vendimeve dhe urdhëresave që nxirren nga ai. Në fillim të takimit kryetari Latifi ka thënë se takime të llojit të tillë do të mbajë çdo tre muaj. "Ju njoftoj se nga takimi i fundit, bazuar në sistemin për vijueshmërinë e punëtorëve në punë, ka pasur përparim për respektimin e orarit të punës. Ashtu siç kam thënë edhe në takimet e tjera, unë jam për respektimin e orarit të punës, në mënyrë që të mos vijë deri te dhënia e vërejtjeve apo edhe heqja e mëditjeve për mosrespektimin e orarit të punës", ka thënë ai.
Latifi u tha punonjëseve se puna e tyre pozitive dhe negative vlerësohet nga OJQ dhe organizata të shumta qeveritare dhe joqeveritare. "Për punën pozitive ne marrim grande të ndryshme, të cilat pastaj i kthejmë te qytetaret përmes projekteve të ndryshme", ka thënë Latifi.

# Kryetarët e Malishevës dhe Mamushës bisedojnë për bashkëpunim mes dy komunave

MALISHEVË, 23 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune kryetarin e Komunës së Mamushës, Abdulhadi Krasniç, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunim të ndërsjellë në fusha të ndryshme mes dy komunave. Fillimisht kryetari Begaj e ka falënderuar kryetarin e Mamushës për vizitën, e më pas kanë biseduar për mundësinë e bashkëpunimit në fushat e ndryshme mes dy komunave, si dhe të dy kryetarët kanë biseduar edhe për investimet në këto dy komuna dhe për sfidat me të cilat përballen komunat.
Begaj e Krasniç u pajtuan për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e administratës, me qëllim të shkëmbimit të përvojave mes dy komunave në fushën e shërbimit të teknologjisë





# Filluan punimet e parkut në Obiliq të vjetër

OBILIQ, 23 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka vizituar fillimin e punimeve në parkun e qytetit në pjesën e Obiliqit të vjetër, me ç'rast ka uruar qytetarët, ndërsa punëkryesve u ka dëshiruar suksese në punë. Ai ka thënë se në ditët në vazhdim komuna do të realizojë edhe projekte të tjera infrastrukturore për zhvillimin e vendit dhe të mirën e qytetarëve.

(Procesi Gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: 6 veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) (3)

# Komiteti i ONDSh-së të grave në Prizren



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Duhet cekur se në Komitetin e Rrethit në Prizren, në kuadër të tij, vepronte edhe komiteti i grave, i cili kishte për detyrë organizimin e grave dhe grumbullimin e ndihmave materiale për grupet që ishin në male. Udhëheqëse e këtij komiteti ishte caktuar: Gjulijana Mateja (kryetare e komitetit të grave), Luçije Bashota, e cila ishte caktuar sekretare e komitetit, anëtare të tij ishin: Roza Mjeda, Laura Shmani, gruaja e Ali Rizës, Roza Cuki, Mona Shyti, Mrika Prenkaj, Nesibe Zhuri dhe Çeçilije Krasniqi.

## Atdhetarët të cilët u arrestuan

**Personat të cilët u arrestuan dhe iu dorëzuan gjyqit nga Komiteti Qendror ishin:**
Halim Spahija, Tahir Deda, Fehim Ibrahimi, Abdullah Rexhepi, Hasan Rrustemi, Maliq Balija dhe Basri Sallkoviqi.
Nga komiteti i Rrethit në Prizren u arrestuan: Xhemil Fluku, Sefedin Ahmeti, Abdullah Hajrullahu, Abdullah Hamza dhe Sinan Hazëri. Nga Komiteti i rrethit në Rahovec u arrestuan: Rifat Krasniqi, Kajtaz Ramadani, Ahmet Dërguti, Kadri Minushi, Sheh Mujedini dhe Vahid Mustafa. Nga komiteti i Rrethit të Suharekës u arrestuan: Xhemil Jemini, Sadik Mehmeti-Peçani, Ibrahim Abdyli, Muhamet Veseli.
Nga komiteti i grave në Prizren u arrestuan: Laura Shmani, italiane, Nesibe Zhuri, motra e Sali Zhurit, Gjulijana Mateja, Mane Shyti, Luçija Bashota, Çeçilije Krasniqi, Roza Mjeda, Mrika Gjoka dhe Roza Cuki.
U arrestuan edhe personat që mbanin lidhjet në mes të grupeve dhe komiteteve: Rexhep Abdullah Kabashi, Kadri Ramadani-Topalli dhe Ruzhdi Kabashi.

## Dënime drakonike u shqiptuan për atdhetarët

Pas arrestimeve të anëtarëve të ONDSh-së, organet e ndjekjes filluan hetimet ndaj tyre. Pas hetimeve të gjata e të mundimshme për të arrestuarit, pas analizave e dëshmive të dëshmitarëve, më 20 tetor 1945 kishte filluar procesi gjyqësor i të pandehurve. Procesi gjyqësor kishte zgjatur 6 ditë. Gjykimi ishte i hapur dhe në të gjitha seancat kishte marrë pjesë Prokurori Publik i Kosovës, Ali Shukria. Më 27 shtator 1945, në sallën e mbushur me të akuzuar në Prizren, ishte shpallur vendimi në emër të popullit të Jugosllavisë dhe të pandehurve që ishin 34 veta, iu shqiptua dënimi si: Halim Spahin, Tahir Dedën, Rifat Krasniqin, Sefedin Ahmetin, Rexhep Avdullah Kabashin dhe Kajtaz Ramadanin me dënimin e vdekjes me pushkatim dhe dënimin e humbjes të përhershme të të gjithë të drejtave politike e qytetare dhe me konfiskimin e tërë pasurisë së tyre.
Ahmet Dërgutin, Kadri Minushin dhe Xhemil Flukun me dënim të humbjes së të drejtave të lirisë dhe me punë të detyrueshme të vazhdueshme 20 (njëzet vjet) me kusht që t'u llogaritet prej ditës së arrestimit dhe me humbjen e të drejtave politike dhe disa të drejtave qytetare, përveç të asaj prindërore në vazhdim prej 10 vjetësh që do të llogariten mbasi të kryhet dënimi.
I. I pandehuri Maliq Balija me dënim humbjen e të drejtave të lirisë dhe me punë të detyrueshme me vazhdim prej 17 (shtatëmbëdhjetë vjet), me kusht që t'i llogaritet ndëshkimi nga data e arrestimit dhe me humbjen e të drejtave politike e disa qytetare përveç asaj të prindërve me vazhdim prej 8 vjetësh e cila do t'i llogaritet mbas kryerjes së dënimit.
II. I pandehuri Abdul Rexhepi me dënim humbje liria dhe pune të detyrueshme të vazhdueshme prej 12 vjet (dymbëdhjetë vjet), me kusht që dënimi t'i llogaritet prej datës së arrestimit, dhe me humbjen e të drejtave politike e disa qytetare përveç asaj princore, të vazhdueshme prej pesë vjetësh që do të llogariten mbas kryerjes së dënimit.
III. I pandehuri Kadri Ramadani me dënim humbjen e lirisë dhe me punë të detyrueshme të vazhdueshme për 10 vjet (dhjetë vjet), me kusht që dënimi t'i llogaritet prej datës së arrestimit dhe me dënim të humbjes të të drejtave politike e disa qytetare, përveç asaj princore të vazhdueshme për pesë vjet, që do t'i llogaritet mbasi ta kryejë burgimin.
IV. I pandehuni Fehim Ibrahimi me dënim të humbjes të lirisë dhe punë të detyrueshme të vazhdueshme 8 vjet (tetë vjet), me kusht që t'i llogaritet dënimi prej datës së arrestimit dhe me dënim humbjen e të drejtave civile përveç atyre prindërore të vazhdueshme për 4 vjet që do t'i llogaritet mbasi ta kryejë ndëshkimin.
V. I pandehuri Basri Sallku Boshnjaku me dënim të humbjes së lirisë dhe punë të detyrueshme të vazhdueshme prej 7 vjetësh (shtatë vjetësh), me kusht që t'i llogaritet dënimi prej datës së arrestimit dhe me dënim të humbjes të të drejtave civile dhe disa qytetare, përveç asaj princore, të vazhdueshme për tre vjet, që do t'i llogaritet mbasi ta kryejë dënimin.
VI. I pandehuri Vahit Mustafa me dënim humbje liria e punë të detyrueshme të vazhdueshme prej 4 (katër) vjetësh, me kusht që dënimi t'i llogaritet që nga data e arrestimit dhe me humbjen e të drejtave politike e disa qytetare, përveç asaj prindërore, të vazhdueshme prej dy vjetëve, që do t'i llogaritet mbasi ta kryejë dënimin.
VII. Të pandehurit Abdullah Hajrullahu, Abdullah Hamëza, Sadik Peqani e Qamil Emini, me dënim humbje lirie e pune të detyrueshme të vazhdueshme për një vit, me kusht që t'u llogaritet qysh nga data e arrestimit.
VIII. Të pandehurit Hasan Rrustemi e Sheh Muhedini me dënim humbje lirie dhe pune të detyrueshme të vazhdueshme për një vit ndëshkim, i cili pezullohet me kondita dyvjeçare.
Lirohen nga aktakuza të pandehurit Sinan Hazëri, Ruzhdi Kabashi, Ibrahim Abdyli dhe Muhamet Veseli për mungesë provash dhe urdhërohet lirimi i tyre në mos qofshin të ndaluar për shkak tjetër.
Ky vendim jepet me të drejtë apelimi me afat 8 ditë.
Vdekje fashizmit, liri popullit!
Prizren 27. IX. 1945
Sekretar: Mustafë Biçoku; anëtar Kolë Shiroka; anëtar Qamil Brovin; dhe kryetar Hivzi Sylejmani.
Nga vitet që iu shqiptuan del e dhëna se 6 persona u dënuan me pushkatim, 4 veta u liruan nga aktakuza, ndërsa grupit iu shqiptuan 124 vjet burg të rëndë.

## Procesi gjyqësor për komitetin e grave të NDSh-së në Prizren

Gjykata Popullore, më 23 tetor 1945, mbajti procesin gjyqësor për gratë, veçan ngaqë i frikohej turmës së grumbulluar para sallës ku mbahej procesi, andaj ishte e detyruar që gratë t'i ndante dhe të mbahej një proces gjyqësor i veçantë. Të gjitha të burgosurat Prokuroria Publike e Kosovës i akuzonte me bazë të nenit 6 të ligjit mbi fajet kundër popullit dhe shtetit në lidhje me nenin 1, pika 10 e 9 dhe nenit 8, alineja 1, të ligjit mbi llojin e dënimeve dhe ligjit mbi konfiskimin e pasurisë dhe ekzekutimin e konfiskimit.
1. Laura Shmanit iu shqiptua dënimi me humbje lirie prej 5 vjetësh burg të rëndë dhe me punë të detyrueshme në vazhdim prej pesë vjetësh. Dënohej me humbjen e të drejtave politike e disa qytetare me përjashtim të atyre prindërore në vazhdim prej pesë vjetësh, aq sa iu kishte llogaritur pas vuajtjes së dënimit dhe me dënim të konfiskimit të një shtëpie në rrugën "Marrshall Tita" në Prizren.
2. E dënuara e dytë ishte Gjulijana Mateja, e cila u dënua me 2 vjet burg, me punim të detyrueshëm në vazhdim prej dy vjetësh, me kusht që dënimi t'i llogaritet nga dita e arrestimit, me humbjen e të drejtave politike dhe disa qytetare, përveç asaj prindërore në vazhdim prej tre vjetësh, që do t'i llogaritet pas vuajtjes së ndëshkimit.
3. Luçije Bashotës Gjykata Popullore i shqiptoi dënimin prej një viti burg, me punë të detyrueshme me vazhdim prej një viti, që do t'i llogaritet prej ditës së arrestimit.
4. Edhe Roza Mjedës gjykata i shqiptoi dënimin prej një viti burg me punë të detyrueshme.
5. Nesibe Zhuri po ashtu u dënua me një vit burg të rëndë dhe me punë të detyrueshme.
6. Roza Cukit iu shqiptua dënimi prej një viti burg, ku ishte e obligueshme për punë të detyrueshme derisa i zgjatë koha e burgosjes. Ndërsa nga aktakuza u liruan Mane Shyti, Çeçilija Krasniqi dhe Mrika Gjoka. Kështu që grave iu shqiptuan 11 vjet burg. Grupit të të burgosurve prej 34 vetave iu shqiptuan 135 vjet burg dhe 7 veta u dënuan me pushkatim, ndërsa 7 veta u liruan nga aktakuza. Mesatarja e dënimeve ishte 6 vjet, 7 muaj e 5 ditë burg. Edhe pse u dënuan dhe vuajtën burgun, të gjithë të dënuarit asnjëherë nuk u penduan dhe nuk i treguan shokët me të cilët vepruan ilegalisht. Bile edhe pas daljes nga burgu disa nga ata kishin vazhduar veprimtarinë ilegale, siç ishte rasti i Nesibe Zhurit, e cila më vonë u angazhua në organizatën ilegale "Lidhja e Prizrenit" që veproi në Prizren.

**(Vijon)**



Кж.-1595/47

У ИМЕ НАРОДА !

Врховни суд Народне Републике Србије у свом већу састављеном од судија: Рада Радовића, као претседавајућег судије, Огњана Ракића и Спасоја Милићевића, као чланова већа и секретара Сергије Гривцова узео је у расматрање жалбе и то: мајке осуђ. Вахита Мустафе, из Мамуше од 29.VII.47 и осуђ. Абдула Реџепа, из Корче од 29.VIII.47, изјављене против решења окружног суда у Призрену Кр.91 и 93/47 од 15.VII.47 год. у крив. предмету против осуђ. Вахит Мустафе, из Мамуше и др., па је на основу чл.56 Зак. о уређењу народних судова дана 6 септембра 1947 год. донео следеће:

Р Е Ш Е Њ Е

Одбијају се жалбе и то: мајке осуђ. Вахит Мустафе, из Мамуше од 29.VII.47 год. и осуђ. Абдуле Реџепа, из Корче од 29.VIII.47, а потврђује се решење окружног суда у Призрену К.91 и 93/47 од 15.VII.47.

О Б Р А З Л О Ж Е Њ Е

Нападнутим решењем одлучено је да нема места примени Указа о помиловању војних лица на осуђене Вахита Мустафу и Абдуле Реџепа.
Противу овог решења уложили су жалбе и то: мајка осуђ. Мустафе и осуђ. Реџепа лично, сматрајући да је нападнуто решење неправилно и предлажући да се исто поништи и да се на наведене осуђенике примену указ о помиловању војних лица.
По расмотрењу свих списа овога предмета Врховни суд је нашао:
Да је осуђ. Мустафа у својству члана тзв. "Демократског националног комитета за срез ораховачки" учествовао у спровођењу организације тог комитета и извршио је низ крив. радњи из чл.3 тач.1 у вези чл.2 ст. 1 Зак. о крив. делима противу народа и државе, а које су радње описане у диспозитиву пресуде којом је осуђени Мустафа оглашен кривим и кажњен за то што је одржавао везу између руководства по м. Комитета и одметника и што је за рачун одметника прикупљао податке о нашој војсци.
Истовремено, осуђ. Реџеп оглашен је кривим и кажњен...
У горњој пресуди је такође утврђено и то да је наведена "Демократски национални комитет" била профашистичка организација повезана са иностраним империјалистима, који раде против постојећег државног уређења у ФНРЈ и да је за рачун свих империјалиста вршила шпијунажу против наше земље.
То значи да је рад осуђених Мустафе и Реџепа у својој основној линији био такође управљен и на то да се за рачун страних империјалиста врши шпијунажа против ФНРЈ.
Са изнетих разлога Врховни суд налази да је првостепени суд правилно нашао да се на осуђ. Мустафу и Реџепа не може применити наведени Указ, зашто је а на основу чл.3 Указа о помиловању војних лица, и одлучио као у диспозитиву.
Решено у Врховном суду Народне Републике Србије, 6 септембра 1947 године Кж.-1595/47.

Секретар,
Сергије Гривцов с.р.

Претседавајући судија,
Рад. Г. Радовић с.р.

За тачност отправка
Претстојник судске писарнице
Велимир Т. Милић

О.Д.

# TË BASHKOHEMI TË GJITHË, TA SHPËTOJMË AGIM BAHTIRIN!



**Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA** me prejardhje nga Shala e Bajgorës, prandaj jam në gjendje në çdo kohë të sakrifikohem për Mitrovicën

**Vlera supreme kombëtare, në rrezik:** Realisht, pjesa nga e ka prejardhjen, ku jeton, ku vepron duke sakrifikuar çdo gjë, Mitrovica ka dhënë, në vazhdimësi, figura të ndritura kombëtare dhe njerëzore që e kanë shkruar historinë dhe pa të cilët kombi shqiptar dikur dhe kombi kosovar sot nuk do ta kishin asnjë kuptim. Nga Mitrovica kanë prejardhjen Isa Boletini (ndonëse rrënjët i kishte në Isniq), Aziz Zhilivoda, Xhafer Deva, Hasan Prishtina ishte aty afër, Ukshin Kovaçiqa dhe shumë të tjerë. Nga Mitrovica është edhe Nexhmedin Spahiu, një ndër baballarët e kombit inekzistent kosovar. Po nga ky qytet është edhe Halit Barani që, në fushën e të drejtave të njeriut dhe atyre kombëtare, ka kontribuar më shumë se të gjitha institucionet komunale të qytetit të ndarë dhe të cilin po bën përpjekje ta bashkojë, edhe me çmimin e jetës, kryepersonazhi im të cilit nuk i vijë as edhe te gishti i vogël. Nga kjo anë, përkatësisht nga Kovaçica e Shalës së Bajgorës, e kam prejardhjen edhe unë e që nuk e meritoj të jem në grupin e të "madhërishmëve", prandaj e lashë veten në fund të listës apo, më mirë të them, në fund të pusit. Kryepersonazhi im është një politikan, para exellance, me përgatitje dhe përvojë të madhe politike sikur që është edhe artist i gjithanshëm, shumëdimensional, i madhi, i papërsëritshmi dhe legjendari Agim Bahtiri i cili, për dy mandate, me sukses të jashtëzakonshëm po e udhëheq qytetin më problematik në Afrikë, Mitrovicën. Me naivitetin tim pata menduar se Hasan Prishtina është shembull i papërsëritshëm i një politikani ideal dhe idealist shqiptar i cili në veprimtarinë e vet bashkëdyzonte dy aktivitete që nuk i kishte asnjë politikan tjetër shqiptar; akti vetëtin politik dhe atë ushtarak. Atë që e tha në Parlamentin turk e bëri realitet sepse u bë udhëheqësi kryesor i kryengritjes shqiptare për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar. Pata menduar, naiv siç jam, se i vetmi politikan shqiptar që mund ta vazhdojë veprën e Hasan Prishtinës është i Pavdekshmi Bacë Adem Demaçi, por u mashtrova si shumë herë në vlerësimin tim. Albin Kurti botërisht deklaroi se Agim Bahtiri është Hasan Prishtina i ditëve tona dhe shpresa për bashkimin e Mitrovicës dhe të Kosovës. Albini kishte të drejtë sepse si Agimi nuk ka tjetër. E la jetën super luksoze në Holandë dhe me mallin e përhershëm dhe të përditshëm për familjen erdhi për t'u shërbyer qytetarëve të Mitrovicës dhe të Kosovës që i kishin humbur shpresat për një të ardhme të bashkuar të qytetit të ndarë. Për këtë arsye e zgjodhi partinë më kombëtare në Kosovë, Aleancën Kosova e Re dhe kryepatriotin e Kosovës, Behgjet Pacollin, në tekstin e mëtutjeshëm Gjet Macolli. E fshiu dominimin e PDK-së në këtë qytet duke e bërë humbësin e kësaj partie, së pari zëvendësministër e pastaj edhe ambasador. E fshiu edhe Valdeten sikur të ishte flutur. E sfidoi shumë Kadrinë dhe i shpalli luftë të hapur ShIK-ut, por jo edhe UDB-së dhe BIA-së. Pasi u shkretuan fushat dhe toka pjellore, e lansoi Kosovën si prodhuesen më të madhe të kërpudhave në Lagjen Kroi i Vitakut. Unë mundohem të jem patriot dhe e adhuroj folklorin e mirëfilltë ku Agim Bahtiri është mbret si dikur Shaban Bajramoviq, me një dhëmbë floriri. Agi i ka bërë flokët me gjel dhe çiçkovo ulje, me të cilën e furnizon Goran Rakiqi nga Mitrovica e Aleksandar Vuçiqit. Agim Bahtiri ishte kundër që Mitrovica të ndahej dhe shumë herë e ka kërcënuar bashkësinë ndërkombëtare sikur edhe vetë Rakiqin me të cilin, edhe fotografohej, por edhe fliste në telefon. Në aspektin estetik, Agim Bahtiri është Monika Belluqi përballë Rakiqit. Në aspektin politik, intelektual dhe profesional, është Winston Churchill apo Bill Gates. Në aspektin e burrërisë dhe trimërisë, është Skenderbe përballë një pitbulliqi nga Mitrovica e veriut. Kurrë nuk e pata nderin dhe privilegjin ta takoj live Agim Bahtirin, por e pata dëgjuar me pasionin më të madh paraqitjen si këngëtar duke luajtur me sharki dhe duke i kënduar këngët patriotike që, edhe të vdekurin e bëjnë të gjallë. Përveç Kadrisë dhe Hashimit, Agimi ia ka treguar muskujt edhe Gjet Macollit, kuptohet, nga distanca.

Realisht, angazhimi i tij i përhershëm, e që bartë rrezikë kolosale, ishte lirimi i Urës mbi lumin Ibër për të cilën po gënjenjë edhe Rakiqi, si eksponent i popullit që gënjeshtrën e ka të kodifikuar gjenetikisht si virtyt dhe art sikur edhe këtyre burokratëve të BE-së që mendojnë se e mashtrojnë gjeniun Bahtiri duke e shëtitur nëpër Bruksel. Tash Hashim Thaçi për të shkuar në Ujman e angazhoi gjysmën e Policisë së Kosovës, të FSK-së dhe të AKI-së sikur edhe forcat e NATO-s dhe Bundesverit, kurse Agim Bahtiri shkoi fikalli vetëm, i shoqëruar vetëm nga Fidani i T7. Krahasoni, ju lutem, këto dy vizita, pastaj nuk e keni vështirë ta gjeni heroin, patriotin dhe sakrifikuesin. Ku ishin Vuçiqi dhe ku ishte Rakiqi në atë kohë si dhe ai varrtari Vulin sikur edhe ai që pshurrej në brekë kur u arrestua nga Policia e Kosovës, Marko Gjuriq? Ishin në birën e miut me çmim 300 groshë!

Agimi është i vendosur ta bashkojë Mitrovicën duke e hapur Urën mbi Lumin Ibër. Ai nuk ka ushtri, nuk ka polici, por e ka Shaqirën nga Kolumbia e cila, pa asnjë dyshim, me të dëgjuar për Agimin, do ta lë edhe Piken vetëm për të kontribuar për bashkimin e qytetit të ndarë të Mitrovicës. Agimi po thotë se është edhe një këngëtare tjetër që do t'i dal në ndihmë Shaqirës nga Kolumbia, por se nuk e zbulon identitetin e saj. Lehtësisht mund të jetë Xhenifer Lopez sepse, për t'i hyrë kësaj pune me shumë rreziqe, duhet t'i kesh bythët e mëdha e Xheniferi i plotëson këto kushte. Nëse ka nevojë për Tomahawk atëherë i propozoj Linda Morinën sepse edhe ajo është artiste e spikatur dhe këngëtare me nam. Apo Çiljetën e cila, megjithatë, e ka zvogëluar kapacitetin goditës. Për mendimin tim, Agimi është treguar shumë i mençur sepse, në përpjekje për bashkim të Mitrovicës, po mbështetet vetëm në femra. Edhe Gadafi personelin e sigurisë dhe goditës e kishte të gjinisë femërore dhe fundin e kishte jo fort të mirë, pikërisht pse e humbi këtë përkrahje.

**Një urti popullore thotë se:** "Uji fle, armiku nuk fle" dhe kështu ka vepruar dhe po vepron edhe Serbia. Ajo nuk po i kërcënon Thaçin, Veselin dhe Hardinajn sepse e di që nuk paraqesin asnjë rrezik. Serbia po e kërcënon me jetë vetëm Agim Bahtirin, hë për hë, për shkak se ka vendosur ta bashkojë Mitrovicën duke e liruar Urën mbi Ibër. Me gjasë, pas Agimit ka shumë mundësi të kërcënohet me jetë edhe Gjet Macolli sepse paraqet rrezik të madh për Serbinë.

Agim Bahtiri e informoi kombin shqiptar kudo që jeton, brenda dhe në diasporë, se është kërcënuar me jetë, në gjuhën serbe për shkak të angazhimit të tij politik dhe kombëtar. Është kërcënuar me postë elektronike e që është krim kibernetik. Në rastin konkret, derisa Policia e Kosovës të dalë me një rezultat, jam i prirë të besoj se dikush me Agimin qartazi ka luajtur koq... e që Agimi po e kapitalizon politikisht. Po të ishte i shkruar ky kërcënim me dorë, lehtësisht do të zbulohej kërcënuesi, duke i krahasuar shkronjat dhe teknikën e shkrimit.

Nuk meriton që Agim Bahtirin ta mbrojë vetëm Gjet Macolli, por duhet të bëhemi të gjithë bashkë, të bëhemi mburojë e gjallë e kësaj vlere njerëzore, kombëtare, politike, morale, kulturore etj. Mos pritni që Agim Bahtirin ta mbrojë Hashim Thaçi i cili nuk është në gjendje ta bëjë dallimin midis Shaqirës nga Kolumbia dhe sharkisë që aq mrekullisht e luan heroi ynë Agim Bahtiri për të cilin duhet të bëjmë të pamundurën që të mos i mungojë as edhe një qime e vetme e b...thes e lërë më koka! Jemi para një sprove të madhe, të sigurisë dhe të interesit madhor kombëtar, mbrojtja e Agimit pa të cilin nuk do të kishin agim të asgjëje, por vetëm perëndim të gjithçkaje. Të gjithë të përbashkuar, në me krye me Albinin në mbrojtje të Agim Bahtirit, ikonës dhe kuptimit të mbijetesës kombëtare. Unë ofrohem vullnetar i përhershëm për këtë mbrojtje, mundësisht të mos jem në radhët e para!

## Ish-kongresisti: ShBA-ja ka armë për ta shkatërruar botën 10 herë




**Uashington, 23 tetor** - "ShBA-ja është e mbushur me armë dhe nuk ka nevojë për një ndërtim të ri bërthamor", deklaroi ish-kongresisti amerikan Ron Paul për RT, duke komentuar kërcënimin e presidentit Donald Trump për ta braktisur traktatin e Forcave të Mesme Bërthamore në Evropë (INF).
Ish-kongresisti republikan dhe kreu i Institutit "Ron Paul për Paqe dhe Prosperitet" tha se ai nuk beson se një tërheqje e mundshme e ShBA-së nga traktati i vitit 1987 do të bënte gjithçka për të rritur sigurinë e Shteteve të Bashkuara. "Trumpi, nëse ecën sipas kërcënimit të tij dhe thyen traktatin historik, të nënshkruar midis presidentit të ShBA-së Ronald Reagan dhe Mikhail Gorbaçov, nuk do të na bëjë ndonjë të mirë", tha Paul. "Kompleksi industrial ushtarak i ShBA-së do të përpiqet të justifikojë ndërtimin bërthamor duke vënë në dukje militarizimin e Kinës, një burim gjithnjë në rritje shqetësimi për themelimin e ushtrisë. Kjo do të thotë se Qeveria amerikane dhe kompleksi industrial ushtarak dëshiron të bëjë më shumë armë, me arsyetimin: 'Kinezët po bëjnë gjithë ato armë, pse ne nuk mundemi?", tha Pauli.

# Trumpi përmend armët kineze në prag të braktisjes së paktit me Rusinë

Presidenti Trump ka thënë se vendimi i tij për t'u larguar nga Traktati Bërthamor është kërcënim për secilin, përfshirë Kinën, Rusinë dhe secilin që përfshihet në këtë lojë



**Uashington, 23 tetor** - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se vendimi i tij për t'u larguar nga Traktati Bërthamor, i nënshkruar me Rusinë dekada më parë, është nxitur jo vetëm nga pretendimet se Moska është duke shkelur këtë pakt, mirëpo edhe nga nevoja për t'iu përgjigjur Kinës në aspektin e krijimit të armëve bërthamore. "Rusia nuk ka vepruar në përputhje me marrëveshjen", ka thënë Trumpi para gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë. "Ne kemi të holla më shumë se askush tjetër. Ne do të ndërtojmë armë derisa ata të vetëdijesohen", ka thënë ai. "Jam duke ndërprerë marrëveshjen sepse ata kanë shkelur paktin", ka thënë Trumpi, mirëpo ai ka thënë se vendimi i tij është "kërcënim për secilin, përfshirë Kinën, Rusinë dhe secilin që përfshihet në këtë lojë. Nuk mundemi. Nuk mund të luani atë lojë me mua", tha ai.
Ndonëse Kina nuk ka qenë kurrë pjesë e Traktatit për Forcat Bërthamore me Rreze të Mesme, i cili është negociuar në kohën e Luftës së Ftohtë në mes të presidentit të atëhershëm amerikan, Ronald Reagan dhe homologut të tij rus, Mikhail Gorbachev, Trumpi ka insistuar që edhe Kina duhet të përfshihet në këtë marrëveshje.
Deklaratat e Trumpit kanë ardhur pasi këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, John Bolton është takuar në Moskë me zyrtarë të lartë të Rusisë, të cilët kanë paralajmëruar se çdo vendim i Uashingtonit për të braktisur Traktatin, do të përbëjë "rrezik" dhe do të nxisë Moskën për të marrë hapa drejt balancimit të fuqisë.
Çdo veprim në këtë drejtim do të përcillet me kundërmasa, sepse stabiliteti strategjik mund të arrihet vetëm në baza të barazisë", ka thënë ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, para se të niste takimin me Boltonin. "Kjo barazi duhet të sigurohet me të gjitha kushtet. Ne kemi përgjegjësi për stabilitet global dhe presim nga ShBA-ja të mos braktisin pjesën e tyre të përgjegjësisë", tha ai.
Boltoni pritet të takohet me presidentin rus, Vladimir Putin për të diskutuar këtë çështje më 23 tetor. Boltoni ka përsëritur argumentin e Trumpit për Kinën në një intervistë për të përditshmen ruse, Kommersant. Ai ka thënë se Shtëpia e Bardhë është e shqetësuar me supozimet për shkelje të paktit nga ana e Rusisë, por edhe për rritjen e kapaciteteve të armëve bërthamore të Kinës, duke e cilësuar këtë të fundit "kërcënim shumë real".
Derisa Bolton e ka pranuar se mund të jetë e paimagjinueshme që të këtë pritshmëri nga Kina për të zbatuar një pakt që nuk ka nënshkruar kurrë, ai ka thënë se zhvillimi i raketave me rreze të mesme në Kinë dhe Korenë Veriore nënkupton që traktati me Rusinë nuk përkon me realitetin e ditës së sotme.
Kina në anën tjetër ka qortuar qasjen amerikane, përmes së cilës ka tentuar të shtyjë Pekinin që të bëhet pjesë e negocimit të armëve. "Duhet theksuar se është plotësisht qasje e gabuar që të përmendet Kina kur bisedohet për tërheqje nga Traktati", ka thënë zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme kineze, Hua Chunying, e cila i ka bërë thirrje Uashingtonit të "mendoj dy herë" lidhur me vendimin e bërë publik.
Ndërkohë analistët për mbrojtje kanë thënë se derisa Rusia dhe ShBA-ja kanë eliminuar gati të gjitha raketat me rreze të shkurtër dhe mesme veprimi, Kina ka ndërtuar gjatë gjithë kohës, një lloj të tillë të armëve.
Duke shkruar për "American Interest", Stephen Sestanovich, ish-drejtori për zhvillimet politike në kohën e Reaganit, në Këshillin amerikan për Siguri Kombëtare, ka thënë se "bashkëpunimi ushtarak në mes të Kinës dhe ShBA-së do të jetë pa dyshim prioriteti kryesor i Pentagonit në të ardhmen". "Mirëpo ideja e të larguarit nga Traktati me Rusinë, duket, të paktën tani, e parakohshme", ka shtuar Sestanovich.
Traktati për Armët Bërthamore ua ndalon ShBA-së dhe Rusisë posedimin, prodhimin dhe zhvillimin e raketave tokësore me rreze nga 500 deri më 5,500 kilometra. Zyrtarët amerikanë kanë thënë se Rusia ka zhvilluar sistem raketor të njohur si 9M72, duke vepruar në kundërshtim me paktin.
Rusia mohon akuzat amerikane dhe pretendon që disa elemente të sistemeve amerikane për mbrojtje në Evropë janë po ashtu në kundërshtim me marrëveshjen, deklarata që Uashingtoni i ka hedhur poshtë.
Rusia ka përmendur shqetësimet për tërheqje të mundshme të ShBA-së nga ky Traktat edhe në Kombet e Bashkuara në orët e vona të 22 tetorit.
Zëvendësdrejtori i Departamentit për kontrollin e armëve në Ministrinë e Jashtme të Rusisë, Andrei Belousov, i ka thënë Komitetit të OKB-së për çarmatim se tërheqja e ShBA-së do të jetë "tejet e rrezikshme" dhe do të "vërtetojë sërish se autoritetet politike dhe ato ushtarake amerikane janë duke kërkuar që të sigurohemi se Ushtria amerikane mban primatin në gjithë botën", në vend që të synojë krijimin e "paqes dhe stabilitetit".

## Turqia paralajmëron Greqinë për kufirin detar

**Ankara, 23 tetor** - Turqia paralajmëroi Greqinë të martën se nuk do të tolerojë një ndryshim në kufirin detar grek. Paralajmërimi vjen pak ditë pasi Athina tha se kishte planifikuar t'i zgjeronte ujërat e saj territoriale deri në 12 milje në perëndim të vendit.
Ujërat territoriale janë një çështje e ndjeshme ndërmjet dy vendeve fqinjë që ndahen nga Deti Egje. Turqia dhe Greqia kanë pasur mosmarrëveshje për shelfin kontinental përkatës prej shumë dekadash. Turqia ka paralajmëruar më parë se nuk do të përjashtonte një veprim ushtarak për të mbrojtur interesat e saj.
Ish-ministri i Jashtëm grek Nikos Kotzias, i cili dha dorëheqje javën e kaluar, tha të shtunën se Athina ka planifikuar t'i zgjerojë ujërat territoriale në detin Jon, por kjo nuk do ta prekte rajonin e Egjeut. Ministria e Jashtme e Turqisë, megjithatë, tha se kishte marrë shënim deklaratat e Athinës rreth planeve për një zgjerim gradual të ujërave territoriale greke.



E rrallë

## Gruaja lind në restorant, mendonte se ishte në muajin e tretë të shtatzënisë



Një grua që mendonte se ishte në muajin e tretë të shtatzënisë ka lindur në restorant. Gruaja kishte humbje gjaku, të ngjashme me ciklin menstrual deri në muajt e fundit dhe nuk ishte në gjendje ta përcaktonte datën e saktë të mbetjes shtatzënë. Fatmirësisht, Chiara është mirë dhe peshon 2.8 kg. Ajo ka lindur në çastet që nëna e saj, Sara Pollesel, gjendej në restorantin që e drejtonte së bashku me burrin. Ngjarja e pazakontë ka ndodhur në Godega, një provincë në Treviso të Italisë.

FOTO E DITES



Të gjithë do të mendojnë se ky vend ndodhet në ndonjë shtet shumë larg Shqipërisë. Në fakt, vendi ndodhet në Divjakë. /Hektor Pustina/

E jashtëzakonshme

## Makina e kafesë prej ari dhe diamante



Ajo quhet Espresso Veloce Royal dhe është një aparat kafeje me vlerë 187 mijë euro. Me një prodhim të kufizuar të frymëzuar nga një motor makine i Formula 1, makina luksoze është e veshur me ar të bardhë 18 karatësh, diamante, gurë ametistë dhe e lustruar me fibra karboni. Gjithashtu, makina është e pajisur me një bombol me vrima nxjerrëse për raki, të përshtatshme për ata që duan të shijojnë një kafe me një shije më të fortë.

## BARSOLETA E DITËS



**Drenicaku: Pse ju gjakovarët nuk i qëroni farat?**
**Gjakovari: Se edhe lëvoret e farave po i blejmë me para.**

KINO ABC PRISHTINE

### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC




### "ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

**Vetem gjate vikendit në ora 14:00**




**Në ora 16:00**

### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
**Regjia:** David Kerr

**Në ora 18:00**

### "NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
**Regjia:** Malcolm D. Lee







**Në ora 20:00**

### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
**Regjia:** Matthew Ross

**Në ora 22:00**

### "VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Në ambientin e punës do të jeni mjaft të vëmendshëm dhe nuk do të reagoni menjëherë. Duhet të përfitoni nga mundësitë e kësaj periudhe për ta dhënë më të mirën nga vetja juaj.



**DEMI**
Në ambientin e punës do të jeni të sigurt për aftësitë tuaja. Në aspektin afektiv disa sjellje tuaja mund të keqinterpretohen nga ana e partnerit tuaj. Gjatë ditës së sotme do të ndiheni mirë.



**BINJAKËT**
Në aspektin afektiv do të jeni gjithëpërfshirës sot. Yjet ju ftojnë të kapni që në ajër mundësitë që jeta jua jep, përndryshe do t'ju duhet të prisni shumë derisa t'ju paraqitet ndonjë mundësi tjetër.



**GAFORRJA**
Në aspektin afektiv diçka do ta turbullojë qetësinë tuaj. Gjatë ditës së sotme do të kujtoheni për ndonjë të papritur apo për ndonjë impenjim në ambientin e punës duke ndryshuar tërësisht planet tuaja.



**LUANI**
Në ambientin e punës do të mund të arrini rezultate pozitive falë impenjimit tuaj konstant. Do të keni mjaft dëshirë të largoheni prej gjërave që nuk ju pëlqejnë.



**VIRGJËRESHA**
Në aspektin afektiv do të jeni të lumtur të merrni një vendim të përbashkët me partnerin tuaj. Në ambientin e punës do t'i konfirmoni edhe një herë aftësitë tuaja menaxhuese.



**PESHORJA**
Në ambientin e punës do t'ju njihen meritat e gjithçka do të shkojë në harmoni. Në aspektin afektiv do të jetë një periudhë mjaft e lumtur. Një familjar i juaji do t'ju japë një sugjerim për të zgjidhur një çështje praktike.



**AKREPI**
Në ambientin e punës duhet të insistoni në idetë tuaja nëse dëshironi të realizoni ato çka keni fiksuar tashmë. Në aspektin afektiv do të jeni mjaft më fat sot, sidomos të gjithë ata që janë singëll.



**SHIGJETARI**
Në ambientin e punës do ta ndiqni drejtimin tuaj pa u kushtëzuar nga askush. Duhet t'i kanalizoni energjitë tuaja drejt një sektori, për ta evituar humbjen e disa mundësive mjaft të rëndësishme për ju.



**BRICJAPI**
Në aspektin afektiv do të jeni mjaft të disponueshëm për t'i plotësuar dëshirat e partnerit. Në ambientin e punës do të përballeni me një situatë të vështirë.



**UJORI**
Në aspektin afektiv do të shfaqeni mjaft intrigues sot në sytë e partnerit. Gjatë ditës së sotme tregohuni të kujdesshëm të mos thoni gjëra që nuk i mendoni! Në ambientin e punës gjithçka është e qetë.



**PESHQIT**
Në ambientin e punës do t'ju duhet të merrni vendime të rëndësishme për të ardhmen tuaj. Gjatë ditës së sotme shumë mundësi janë duke mbërritur, ndaj mundohuni ta tregoni anën tuaj më të mirë.

# Dukeshës Kate nuk i ulet fustani



Dukesha e Cambridge, Kate Middleton, apo ajo që pritet të jetë edhe mbretëresha e ardhshme e Britanisë së Madhe, duket se ka probleme me fustanet, pasi i qëndrojnë të ngritur. Ndoshta është çasti që bashkëshortja e princit William ta ndërrojë rrobaqepësen!

# Gigi Hadidi, një sirenë me rroba të kuqe



Mund të jetë tetor, por në plazhet e Ipanemas në Rio de Janeiro, Brazil, dielli po ndriçon. Gigi Hadid ishte atje gjatë së premtes së kaluar për të bërë një set fotografish me rroba banje. Modeluesja ka lënë përshtypjet më të mira përpara aparatit fotografik duke vrapuar përgjatë rërës.



# Afërdita Dreshaj, çaste romantike me bashkëshortin

Këngëtarja dhe modeluesja e njohur shqiptare, Afërdita Dreshaj, po jeton si në përralla. Afërdita Dreshaj është martuar me hokeistin çek Jakub Kindl dhe shpeshherë ka treguar se pranë tij ndihet tejet e lumtur. Në një çast romantik dyshja shihen edhe në foton e fundit të publikuar në rrjetin social "Instagram". "Në krahët e t'u, përgjithmonë", ka shkruar Afërdita pranë imazhit të postuar ku edhe ka pranuar komente të ndryshme nga ndjekësit.

# Emily Ratajkowski, e dashuruar dhe e lumtur



Emily Ratajkowski ka surprizuar fansat kur kishte njoftuar se ishte martuar me Sebastian Bear-Mcclard në Nju Jork në muajin shkurt, ndonëse kishte vetëm pak javë që ishte lidhur me të. Mirëpo, duket se gjërat mes tyre po shkojnë mjaft mirë. Modeluesja ka shpërndarë një foto në llogarinë e vet në "Instagram" teksa shkëmben një puthje me bashkëshortin. Çifti po shijon lumturinë pa e vrarë shumë mendjen së çfarë mendojnë të tjerët.

# Identiteti dhe Estetika, përm

Edhe pse shumë mendojnë se veshja ka origjine estetike, ajo së pari lindi si nevojë, për të mbrojtur trupin nga faktorët klimatikë, për t'u ndjerë më i mbrojtur nga faktorë të ndryshëm. Ashtu si veglat e punës apo ushqimi edhe veshjet konsiderohen ndër mjetet kryesore të jetës së njeriut. Veshjet mund të interpretohen si një gjuhë që komunikon një numër funksionesh. Këto funksione shprehin qëndrime brenda komunitetit lidhur me idealet sociale, estetike, morale dhe nacionaliste. Gradualisht në procesin e zhvillimit të shoqërisë njerëzore u krijuan veshje në përshtatje me stinën, me gjininë, me vendin, me moshën, statusin social.

I gjithë zhvillimi i veshjeve, është i lidhur ngushtë me historinë e zhvillimit të një vendi. Një nga aspektet e rëndësishme të mënyrës së jetesës janë veshjet popullore të cilat me larminë e tyre pasurojnë Identitetin dhe trashëgiminë kulturore të një vendi. Veshja popullore i referohet veshjeve të popullatave rurale të angazhuara në bujqësi, blegtori, peshkim etj.. E quajtur ndryshe si veshje fshatare, rurale ose rajonale, mund të konsiderohet edhe veshje etnike në rajonet më me shumë se një grup etnik.

Në të gjitha rastet, veshja popullore identifikoi njerëzit me një vend. Ende sot e nderojmë fustanin tradicional të vendit, duke e veshur atë shpesh nëpër festivale kombëtare dhe raste të veçanta ceremoniale. Vendet e Ballkanit kanë një histori të gjatë dhe të pasur të veshjes popullore.

Shtresa e mesme dhe e lartë e shoqërisë në shekujt e shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë, mbanin një stil kombëtar, me elemente të pasura zbukurimesh e me motive gjeometrike, disa prej të cilave ishin simbolet fetare-fisnore, e tokës dhe e pjellshmërisë; përdorimi i monedhave metalike si varëse në qafë dhe në kokë. Konkurrueshmëria e grupeve etnike dhe fetare, veshja e të cilëve ndryshon nga njëri-tjetri në formë ose dekor, kishte ndikim të fortë të veshjeve Turke, pasi këto vende dikur ishin pjesë e Perandorisë Osmane.

Gjithashtu modelet e këtyre veshjeve kishin ndikim edhe nga kulturat perëndimore si dhe vendeve të tjera lindore. Për shkak të pozicionit gjeografik të Shqipërisë dhe kushteve të zhvillimit historik apo dallimeve klasore, tipologjia veshjeve popullore shqiptare nuk ka asgjë të përbashkët me ato të huajat. Komponentë të tjerë të veshjes popullore shqiptare kane gjurmë shumë më të hershme.

Ato filluan të marrin pamjen e tyre në kohën e formimit të principatave feudale, në shek. XII. Midis tyre ndër më të vjetrat konsiderohen këmishët e gjata, xhubleta, fustanellat e burrave, pelerinat, etj, ku mjaft elemente vijnë nga periudha më të hershme të kulturës ilire. Kështu xhubleta përfaqëson veshjen më të hershme në Shqipëri dhe në Ballkan. Ajo sjell mesazhet e qytetërimit ilir në kulturën popullore shqiptare gjë që përcakton përkatësinë etnike të tyre. Lulëzimi i vërtetë i veshjes popullore ndodhi në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Disa nga përdorimet më të vjetra rituale të veshjes popullore mbizotëruan, në ceremonitë e martesës dhe mbulimi i nënave të reja me shamitë mëdha prej liri. Veshja popullore, përdorej në një ditë të veçantë, siç është e diela, festat. Ajo tregonte statusin social dhe pasurinë, përkatësinë fetare etj. Duke krijuar atë pasuri e larmi të madhe veshjesh të kostumeve popullore, gjurmët e të cilave u ruajtën deri në shek. XX.

Etnologët e hershëm nisën mbledhjen sistematike të këngëve, legjendave, miteve dhe shembujve të veshjes rajonale për të forcuar argumentin për ekzistencën e një Identiteti kombëtar. Ndërkohë në







# es artit të veshjes popullore



Shqipëri koleksionet e para muzeale u krijuan mbas Luftës së Dytë Botërore. Priftërinjtë françeskanë grumbulluan 300 veshje nga krahina të ndryshme të vendit.
Sot me anë të zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme etno-kulturore, veçanërisht për zhvillimin e turizmit kulturor në Shqipëri, por mbi të gjitha në promovimin e traditave dhe trashëgimisë kulturore të vendit janë duke u rijetëzuar shtëpitë e artizanatit të cilat gjatë këtyre dekadave të fundit ishin në zhdukje.
Një model i muzeut të artit të veshjes tradicionale shqiptare është "Tradita Folk." Ky muze është pjesë e aktiviteteve të ndryshme të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit i cili ka tërhequr vëmendjen e shumë vizitorëve të huaj.
Muzeu jo vetëm ruan dhe koleksionon veshjet popullore që datojnë që nga shek XIX- të , por gjithashtu fal pasionit dhe dëshirës, përkushtimit dhe përvojës 15- vjeçare të zj. Edlira Sulaj, në studimin teknik të tyre, sot muzeu riprodhon veshje popullore nga të gjitha krahinat e Shqipërisë me të njëjtën teknikë duke ruajtur kështu jo vetëm origjinalitetin e veshjes por shpirtin dhe kulturën e një kombi.
Ky Muze, në muajin e Trashëgimisë Kulturore Evropiane, ka zhvilluar shumë aktivitete artistike. Më e fundit ishte aktiviteti i Ditës Ndërkombëtare të grave dhe vajzave rurale, organizuar në bashkëpunim me Presidencën e Republikës me pjesëmarrjen e diplomatëve të huaj në Shqipëri.
Në këtë event, u bë prezantimi i veshjeve tradicionale origjinale të punuara mbi 100 vite më parë si dhe ato të riprodhuara me mjeshtëri nga drejtuesja e muzeut se bashku me stafin e saj, e cila ka ngritur një laborator të mirëfilltë brenda ambienteve të këtij muzeu.
Studimi dhe ruajtja e veshjeve popullore ka rëndësi jo vetëm për të njohur këtë pasuri të madhe kulturore, elementet e të cilave vijnë nga lashtësia dhe nga periudha mesjetës, por për të njohur njëkohësisht marrëdhënien kulturore me popujt e tjerë gjatë shekujve.

*(Elda Shabani / gazeta-Shqip.com)*

# Coco Chanel, historia e një gruaje që ndryshoi miliona gra

Gabrielle Chasnel, e njohur më vonë si Coco Chanel, është një nga femrat që vijon të frymëzojë edhe sot me jetën dhe modelet që la pas. E njohur për markën e saj simbolike, Coco Chanel mbetet sot simboli i elegancës franceze. Në të vërtetë, ajo njihet si e tillë në universin e modës dhe në mbarë botën.
Gabrielle Chasnel, ka qenë një grua shumë diskrete për jetën e saj private, pavarësisht nga fama e saj botërore. Kjo është arsyeja pse rinia e saj nuk është shumë e njohur. Në të vërtetë, historianët hezitojnë mes një fëmijërie të kaluar në abacinë e cistercit pas vdekjes së nënës … dhe asaj të kaluar me kushërirat e nënës së saj të ndarë nga jeta. Si do që të jetë, Gabrielle Chasnel mëson të qepë që në fëmijërinë e saj të hershme dhe përmirësohet e përsoset në vazhdimësi deri sa bëhet rrobaqepëse tek Moulins.
Por Gabrielle Chasnel është i hipnotizuar nga jeta mondane, dhe nis të frekuentojë vendet elegante. Në moshën 24 vjeç, ajo nis të këndojë nëpër music-halls. Pseudonimi "Coco" iu dha pikërisht sepse ajo këndonte shumë shpesh këngën "Kush e pa Coco-n në Trocadero". Shumë shpejt, ajo bëhet një artiste shumë tërheqëse. Gjatë jetës së oborrit me të dashurin e saj ajo nis të realizojë krijimet e saj të para që konsideroheshin shumë mashkullore për kohën.
Ndryshe nga çdo pritshmëri, Coco Chanel nis të bëhet e njohur e të imponojë stilin e saj në botën e modës si kapelebërëse. Ndryshe nga të gjitha tendencat e epokës, stili i saj i pastër avangardist nis të njohë një sukses në rritje. Në vitin 1910 i dashuri i saj Boy Capel, mbështet financiarisht hapjen e dyqanit të saj të njohur në rrugën Cambon. Më pas, ajo hap dyqane në qytete të tjera, në fillim në Deauville, më pas në Biarritz. Çdo dyqan i ri është i suksesshëm, e në të njëjtën kohë krijimet bëhen më të larmishme, kapele, funde, fustane…Klientela e saj përbëhet nga borgjezia e vjetër tashmë e tërhequr jashtë Parisit për shkak të luftës.
Shumë shpejt stili i Coco Chanel bëhet i domosdoshëm. Për shkak të kufizimeve të luftës dhe mungesës së pëlhurave, ajo frymëzohet nga bota sportive dhe kodet mashkullore. Ajo shpik një stil të ri: larg nga korsetë e ngurta, krijon veshjet e thjeshta dhe të rehatshme, gjithnjë elegante, duke zbuluar një stil të përzier mashkullor-femëror.
Coco Chanel zgjeron dyqanin e saj në Rue Cambon, dhe punëson rreth 200 rrobaqepëse. Kompania e saj i merr pëlhurat nga fabrikat e saj në Normandi. Ajo zhvillon stilin e saj të pastër dhe të thjeshtë, duke thyer kodet e kohës, dhe duke rizbuluar feminitetin tek aksesorët. Një vizionare e vërtetë, ajo është rrobaqepësja e parë që ndërmerr edhe markën e saj të parë të parfumeve. Krijohet dhe fustani i i zi mitik. Pak kohë më pas, ajo krijoi një markë bizhuterish në emrin e saj dhe në vitin 1939, perandoria e saj përbëhej nga 4000 rrobaqepëse që i përgjigjen gati 30.000 porosive në vit.
Megjithatë, lufta vazhdon dhe Coco Chanel largohet për në Zvicër ku do të jetojë 10 vjet. Ndërkohë që kthehet në Francë, stilisti Christian Dior ishte gjithashtu imponuar si një referencë në botën e modës gjë që ndikon në veprimtarinë e shtëpisë Chanel. Megjithatë, ajo hedh në treg koleksione të reja të cilat ndikuan në ruajtjen e pozicionit dhe famës së Chanel.
Coco Chanel u nda nga jeta në vitin 1971, në moshën 87 vjeçare. Ajo e shënjoi epokën e saj me hijen e saj të rreptë por po aq të famshme, që ende vazhdon të jetë e pranishme në botën e modës. Në sajë të Chanel moda u bë një pjesë esenciale e kulturës franceze.

*(gazeta-Shqip.com)*






# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DORTMUND - ATLETICO MADRID | 1 | PSV - TOTTENHAM | 3+ | BRISTOL CITY - HULL | 1 |

# Ministri Gashi: Gjashtë milionë euro më shumë për sport

Ministri Kujtim Gashi ka bërë me dije se buxheti për sport vitin e ardhshëm do të rritet edhe për gjashtë milionë euro. "Komiteti Olimpik i Kosovës dhe sportistët pjesëmarrës nëpër lojërat olimpike do ta kenë përkrahjen e plotë të ministrisë. Buxheti për vitin 2019 për sportin do të rritet edhe 6 milionë euro të tjera nga sa ka qenë këtë vit", ka thënë Gashi



**Prishtinë, 23 tetor** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, priti në takim sportistët që e përfaqësuan Kosovën në Lojërat Olimpike për të rinj, që u organizuan në Buenos Aires të Argjentinës nga 6 deri 18 tetor 2018, notaren Melisa Zhdrella, boksierin Erdonis Maliqi, atletin Muhamet Ramadani, trajnerët e sportistëve dhe drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, të kryesuar nga Besim Hasani.

Ministri Gashi u shpreh i kënaqur me përfaqësimin e Kosovës nga sportistët, të cilët nuk u kthyen duarthatë nga Argjentina, pasi e fituan një medalje të bronztë. Ministri Gashi ka rikonfirmuar se duhet që të gjithë të angazhohen për ngritjen e mëtejme të cilësisë në sport. Ai ka premtuar se MKRS-ja do ta rrisë edhe më tej përkrahjen për sportistët dhe do ta rrisë buxhetin edhe më shumë për sportin në përgjithësi. "Komiteti Olimpik i Kosovës dhe sportistët pjesëmarrës nëpër lojërat olimpike do ta kenë përkrahjen e plotë të ministrisë. Buxheti për vitin 2019 për sportin do të rritet edhe 6 milionë euro të tjera nga sa ka qenë këtë vit", ka thënë ministri Gashi.

Numri një i ministrisë së sportit ka porositur sportistët që të angazhohen maksimalisht që në pjesëmarrjet e tyre në garat ndërkombëtare të përfaqësojnë sa më denjësisht Kosovën, sepse sportistët janë ambasadorët më të mirë të vendit tonë të cilët përmirësojnë imazhin e shtetit dhe promovojnë vendin tonë në arenën ndërkombëtare. Ndërsa kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka thënë se vizita e ministrit Gashi me bashkëpunëtorë në Buenos Aires ishte një inkurajim shtesë për sportistët. "Vizita dhe prania e delegacionit të Kosovës në Argjentinë, i prirë nga ministri, është vlerësuar edhe nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, me ç'rast kanë ndarë edhe mirënjohje për delegacionin nga Kosova", ka deklaruar Hasani.

Ai shprehu kënaqësinë për rritjen e buxhetit për sportin duke pohuar se kjo do të ndikojë në rritjen e cilësisë dhe masivitetit në sportin e Kosovës. Lojërat e ardhshme Olimpike për të rinj mbahen për herë të parë në kontinentin e Afrikës, konkretisht në Dakar të Senegalit, të cilëve iu dorëzua organizimi për vitin 2022.

## SHKURT

### KB Trepça forcohet edhe me një amerikan

Forma e dobët e Klubit të Basketbollit Trepça në këtë edicion në Superligën e Kosovës ka bërë që drejtuesit e saj të reagojnë edhe me një përforcim. Trepça të martën ka njoftuar se ekipit gjatë këtyre ditëve do t'i bashkohet krah-qendra James Jackson i cili do të jetë i gatshëm për ndeshjen e fundjavës kundër Ponte Prizrenit, që luhet të dielën (17:00) në Mitrovicë. Në radhët e Trepçës aktualisht janë dy amerikanë: Mark Dorris e Dwayne Miner. Trepça është ekipi i vetëm elitar që ende nuk ka regjistruar fitore në pesë xhirot e para të këtij edicioni. Zë vendin e fundit në tabelë me vetëm pesë pikë të tubuara.

### Shaqiri: Tifozët e Zvezdas do të më vërshëllejnë, por është normale

Kur shorti i Ligës së Kampionëve përplasi në të njëjtin grup Liverpoolin dhe Crvena Zvezdan u përfol shumë për vizitën e Xherdan Shaqirit në Beograd. Tifozët serbë e shtuan dozën e urrejtjes ndaj mesfushorit nga Gjilani pas festës me shqiponjë që bëri në ndeshjen Zvicër - Serbi në Botëror. 27-vjeçari u gjobit nga FIFA së bashku me Granit Xhakën dhe tani përgatitet për t'i përjetuar emocionet e një tjetër sfide kundër skuadrës serbe në "Anfield" dhe pas dy javësh në "ferrin" e kryeqytetit serb. Pas hedhjes së shortit, drejtori i përgjithshëm i Crvena Zvezdas, Zvezdan Terziq, ka thënë se Shaqirin e pret një presion i jashtëzakonshëm psikologjik kur të luhet në "Marakana". Por, futbollisti është përpjekur gjithnjë që t'i zbusë notat e tensionit politik përpara ndeshjes. I pyetur nga "Liverpool Echo" nëse do të jetë i shqetësuar se do të jetë një shënjestër e tifozëve serbë, Shaqiri është përgjigjur: "Jo, aspak. Është thjesht një ndeshje normale dhe unë do ta trajtoj atë si të tillë. Sigurisht se mund të ketë disa tifozë që do të më vërshëllejnë. Por, unë do ta trajtoj si të ishte një takim normal. Në fund është vetëm një ndeshje futbolli. Është një ndeshje e rëndësishme dhe ne duam të fitojmë. Sporti nuk është politikë".

### Kololli: Ndaj Ishujve Faroe mungova për shkak të lëndimit

Benjamin Kololli ishte lojtari kryesor i Kosovës në ndeshjen ndaj Maltës (3-1), por në ndeshjen ndaj Ishujve Faroe mungoi. Federata e Futbollit e Kosovës e njoftoi opinionin se Kololli ishte lënduar, por ai shumë shpejt u paraqit për skuadrën e vet në Zvicër. Kur kanë kaluar më shumë se dhjetë ditë, Kololli nëpërmjet një njoftimi në "Facebook" ka treguar arsyet pse është larguar nga Përfaqësuesja e Kosovës para ndeshjes me Ishujt Faroe. "Dua të sqaroj për gjithë opinionin e gjerë, për tifozët 'Dardanët' dhe të gjithë kosovarët që mosudhëtimi im në ndeshjen në mes të Kosovës dhe Ishujve Fareo, ka qenë për shkak të përsëritjes së një lëndimi që kam vuajtur në katër ndeshjet paraprake, para ndeshjes me Maltën dhe gjatë ndeshjes me Maltën më është përsëritur lëndimi. Kjo ka qenë e gjithë arsye e mosudhëtimit tim dhe jo diçka tjetër për çka është folur. Fatmirësisht, nuk ka qenë lëndim serioz, por më është dashur t'i kam dhjetë ditë pushime për shkak të kalendarit. Jam rikthyer shumë shpejt pas ekzaminimeve mjekësore. Do të rikthehem edhe për Përfaqësuesen më i fortë se kurrë në ndeshjet e ardhshme", ka shkruar Kololli. Ka pasur zëra se Kololli është larguar pas mosmarrëveshjeve me Valon Berishën.

## Mes Marseillet e Lazios, Cana zgjedh francezët



**Tiranë, 23 tetor** - Ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana, do të bëjë tifo për Olympique Marseillen në ndeshjen e Ligës së Evropës që ekipi francez e luan kundër Lazios. Cana gjatë karrierës aktive ka luajtur për të dyja ekipet derisa te Marseille ka bartur edhe shiritin e kapitenit. Dueli mes këtyre dy ekipeve zhvillohet të enjten mbrëma prej orës 21:00 në Francë dhe i takon xhiros së tretë të Grupit H. "Unë jam dhe do të mbetem tifozi më i madh i Marseillet. Besoj se Marseille ka ekip për ta mposhtur Lazion", ka deklaruar Cana. Lazio aktualisht zë vendin e dytë në tabelë me tri pikë derisa Marseille është i treti me një pikë. Krahas këtyre dy ekipeve, Cana karrierë ka bërë edhe te PSG-ja, Sunderlandi e Galatasaray.

## FFK-ja shpërndau topat për klubet e Superligës dhe Ligës së Parë



PRISHTINË, 23 TETOR - Për të siguruar një top unik për zhvillimin e ndeshjeve kampionale, Federata e Futbollit të Kosovës sot ua shpërndau nga 10 topa klubeve të IPKO Superligës dhe nga pesë topa klubeve të Ligës së Parë, të cilët ua dorëzuan kryetari i FFK-së, Agim Ademi dhe sekretari i Përgjithshëm, Eroll Salihu. "Kjo nuk është ndonjë ndihmë e madhe, por se jemi duke u përpjekur që të bëjmë një top unik për tërë ligën dhe besoj që shpejt do të kalojë në një brend të pastër të FFK-së. Jemi duke u përpjekur që jo vetëm t'i mbështesim klubet, por edhe ta ngrehim nivelin e ligës që është kërkesë edhe e UEFA-s", ka thënë Ademi, i cili përfaqësuesve nga Liga e Parë u ka bërë me dije se as ky rang garash nuk është lënë anash nga Federata e Futbollit.

# Barça pa Messin ndaj Interit, PSG-ja ka punë me Napolin

BARCELONË, 23 TETOR (ER) - Skuadra e Barcelonës do të luajë sonte (e mërkurë) në "Camp Nou" ndeshjen e Ligës së Kampionëve ndaj Interit pa lojtarin më të mirë, Lionel Messin. Kjo ndeshje i takon grupit B dhe zhvillohet nga ora 21:00. Ylli argjentinas është lënduar në ndeshjen kundër Sevillas (4-2) dhe, përveç Interit, pritet ta humbasë edhe "El Calasic"-on ndaj Real Madridit. Në mungesën e tij, Barcelona pritet të luajë në sulm me Luis Suarezin, i cili do të mbështetet nga Philippe Coutinho dhe Ousmane Dembele. Barcelona nga dy ndeshjet e para ka marrë gjashtë pikë, po aq sa ka edhe Interi. Kjo e fundit kishte arritur fitore ndaj Tottenhamit në minutat e fundit, sikurse që shënoi edhe në derbin e Serisë A, kundër Milanit në minutat shtesë. "Nerazzurët" pas disa rezultateve pozitive janë të motivuar për ndeshjen ndaj Barçës. Ndeshje tjetër derbi sonte zhvillohet edhe në Paris të Francës, ku skuadra e Paris Saint Germainit e pret Napolin e Elised Hysajt. PSG-ja, që momentalisht renditet e treta në grupin C, do të mundohet për të marrë një fitore e cila do t'i rriste shpresat për të garuar edhe për pozitën e parë. Ndërsa Napoli me strategun Carlo Ancelotti nga Parisi pret të dalë i pamposhtur në mënyrë që të mbetet në garë për kualifikim në fazën tjetër. Derbi i madh zhvillohet edhe në Gjermani në mes të Borussia Dortmundit dhe Atletico Madridit.



**GRUP A**

18:55 Club Brugge - Monaco
21:00 Borussia Dortmund - Atletico Madrid

Tabela

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Borussia Dortmund | 2 | 6 |
| 2. Atletico Madrid | 2 | 6 |
| 3. Club Brugge | 2 | 0 |
| 4. Monaco | 2 | 0 |

**GRUPI C**

21:00 Liverpool - FK Crvena Zvezda
21:00 Paris Saint Germain - Napoli

Tabela

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Napoli | 2 | 4 |
| 2. Liverpool | 2 | 3 |
| 3. Paris Saint Germain | 2 | 3 |
| 4. Crvena Zvezda | 2 | 1 |

**GRUPI B**

18:55 PSV Eindhoven - Tottenham Hotspur
21:00 Barcelona - Inter

Tabela

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Barcelona | 2 | 6 |
| 2. Inter | 2 | 6 |
| 3. Tottenham H. | 2 | 0 |
| 4. PSV | 2 | 0 |

**GRUPI D**

21:00 Galatasaray - Schalke 04
21:00 Lokomotiv M. - Porto

Tabela

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Porto | 2 | 4 |
| 2. Schalke | 2 | 4 |
| 3. Galatasaray | 2 | 3 |
| 4. Lokomotiv M. | 2 | 0 |

# Toronto arrin fitoren e katërt, San Antonio fiton pas kohës shtesë

TORONTO, 23 TETOR - Toronto korri fitoren e katërt këtë sezon në NBA, duke mundur 127-106 Charlotten. Skuadra kanadeze po kalon një moment të mirë, ende e pamposhtur, duke treguar epërsi në fushë edhe në ndeshjen e radhës. Një ndeshje e mirë e Leonardit, autor i 22 pikëve, ndërkohë që 54 pikë u realizuan nga lojtarët që e nisën takimin nga stoli. Humbet ekipi i Bostonit, që u mund 93-90 nga Orlando, ndeshje e komanduar nga miqtë, që në fund rrezikuan shumë. Të gjithë titullarët e Orlandos realizuan mbi 10 pikë, me Vucevic që ishte shënuesi më i mirë me 24 pikë e 12 rebaunde, duke i bërë të pavlefshme 22 pikët e Irvingut për Celticsin. Pas kohës shtesë fiton ekipi i San Antonios, që mundi 143-142 Lakersin, një ndeshje spektakolare dhe emocionuese deri në fund. Kuzma realizoi 37 pikë e Jamesi 32, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen e tretë sezonale (ende asnjë fitore), ndërsa për Spursin u dalluan Aldridge me 37 pikë e DeRozan me 32 pikë e 14 asistime. Rikthehet te fitorja edhe ekipi kampion i Golden States që mundi 123-103 Phoenixin, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Warriorsit, me Curryn që realizoi 29 pikë e Duranti 22. Fiton edhe Dallasi, që mundi 115-109 Chicagon, sfidë ku u dallua Matthewsi me 20 pikë, ndërsa Washingtoni mundi 125-124 Portlandin pas kohës shtesë (Morrisi 28 pikë).



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Boston - Orlando | 90-93 |
| Toronto - Charlotte | 127-106 |
| Milwaukee - New York | 124-113 |
| Minnesota - Indiana | 101-91 |
| Dallas - Chicago | 115-109 |
| Utah Jazz - Memphis | 84-92 |
| Portland - Washington | 124-125 |
| Golden State - Phoenix | 123-103 |
| Lakers - San Antonio | 142-143 |

## SHKURT

### Emery: Ozili duhet të luajë kështu në çdo ndeshje

Mesut Ozil ka shkëlqyer në ndeshjen Arsenal - Leicester City (3-1), kurse trajneri Unai Emery ka thënë se mesfushori në këtë mënyrë duhet të luajë në çdo ndeshje. "Për Mesutin ishte një performancë shumë e mirë, si dhe një fitore e mirë për të gjithë së bashku. Por, ne do të vazhdojmë të shtyjmë përpara dhe të kërkojmë nga vetja dhe nga ai që të performojmë kështu rregullisht. Është e rëndësishme që kapiteni të sillet si lider në situata të tilla. Por, ne kemi shumë lojtarë brenda skuadrës që janë në gjendje dhe janë të gatshëm ta bëjnë një gjë të tillë. Mendoj se Ozili mund të luajë në çdo ndeshje me po të njëjtin përkushtim dhe kualitet, pavarësisht nga shiriti i kapitenit", ka thënë Emery.

### Sane pëlqehet nga Bayerni, por City nuk e shet

Leroy Sane është një nga futbollistët që po spikatin te Manchester City dhe drejtuesit e klubit janë vënë në lëvizje menjëherë për t'i rinovuar kontratën. 22-vjeçari është i lidhur me "qytetarët" deri në verën e 2021-shit, por së fundi ndaj tij ka shfaqur interes të fortë gjiganti i futbollit gjerman, Bayern Munchen. Pikërisht për këtë arsye, drejtuesit e Cityt janë gati t'i ofrojnë një kontratë të re, me afat të paktën deri më 2023-shin dhe, para së gjithash, një klauzolë që vështirëson largimin. Sane u la jashtë botërorit "Rusi 2018" nga trajneri Low, por duket se është rikthyer sërish te kombëtarja gjermane dhe pritet të marrë një rol të rëndësishëm tashmë.

### Reali e mendon rikthimin e Mourinhos

Një ditë pasi u publikua lajmi se Real Madridi është duke u interesuar për transferimin e sulmuesit Zlatan Ibrahimoviq, e përditshmja "El Pais" raporton se Reali e dëshiron rikthimin e trajnerit Jose Mourinho. Drejtuesit e Realit nuk janë aspak të kënaqur me Julen Lopetegin, prandaj Mourinho po konsiderohet një opsion i mirë. Portugezi është trajner i Manchester Unitedit, por javën e kaluar është folur për një shkarkim të mundshëm.

### 44 klube dhe 171 lojtarë nën hetime në Angli

Dogana e Anglisë ka bërë me dije se është duke i hetuar 44 klube dhe 171 lojtarë të përfshirë në nivelet e ndryshme të futbollit në Angli për shkak të dyshimeve se ata i janë shmangur pagimit të taksave. Autoritetet për pagimin e taksave në Britani të Madhe i kanë rikthyer rreth 374 milionë euro nga taksat që nuk ishin paguar nga personat e përfshirë në industrinë e futbollit që nga sezoni 2015/2016. Së fundi, Dogana e Anglisë e ka konfirmuar se është duke i hetuar 44 klube angleze, 171 futbollistë si dhe 31 agjentë për mospagimin e taksave. Ky numër ka pësuar rritje të madhe në krahasim me shtatorin e kaluar, kur nën hetim ishin 90 futbollistë, 38 klube dhe 13 agjentë. "Ne jemi duke i analizuar me kujdes marrëveshjet individuale mes klubeve të futbollit dhe lojtarëve të tyre për t'u siguruar se ata janë duke e paguar shumën e duhur të taksave në Britani të Madhe", ka thënë zëdhënësi për media i Doganës. "Për momentin, jemi duke i hetuar rastet e 171 futbollistëve, 44 klubeve të futbollit dhe 31 agjentëve për disa probleme të ndryshme, përfshirë këtu edhe abuzimin e të drejtave të imazhit".
Dogana e Anglisë dyshon se klubet dhe futbollistët kanë qenë duke i shfrytëzuar të drejtat e imazhit për të mos i paguar taksat. Që nga viti 2000 futbollistët e kanë pasur mundësinë t'i trajtojnë paratë e fituara nga të drejtat e imazhit si të veçanta nga paratë e fituara në klubet e tyre.



**Autor: GAZMEND MORINA**

AKTORJA ITALIANE NË FOTO (shqip.)
MBARIMI I BOTËS (pashq.)
MË VJEN GJUMË E MË VARET KOKA DUKE NDENJUR
AMPER, JEMEN, ELEKTRON
RRALLË (lat.)
ZANORE
MEKANIZËM QË SHËRBEN PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE TË RËNDA
KRAHINË NË KOSOVË
I ÇELE
ZYRË NDIHME JURIDIKE QË MERRET ME VEPRIMET NOTERIALE
FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË (pashq.)
BASHKËT. / SHTIM NATYROR I POPULLSISË
MARKË E VESHJEVE SPORTIVE (origj.) / FURRË KU PIQEN TULLA
AKTORI HOLLIVUDIAN .. PAÇINO
ZË ME DORË / QË NUK I PËRKET FESË DHE KLERIT
CEREMONITË FETARE
MJET PUNE
LIRIDON (perkdh.)
EPOKA E RE
LUMË NË KOSOVË
DYPALËSH
BASHKËT. / SPIKERJA ...... MURTEZI - SHALA
EPOKA E RE
KANAT
PROVINCË NË ITALI
ZANORE
EPOKA E RE
QYTET MË GJERMANI (pashq.)
PARA TË DYTËS / "I" në mes të dy "E"
PARAARDH-ËSI YNË / IKANAK
BISHT I FRUTIT TË DISA PEMËVE E PERIMEVE
NJËRI NGA KATËR SHTETET QË FORMOJNË MBRETËRINË E BASHKUAR / ZANORE
QË KA TË BËJË ME LITERATURËN / RRJETËZË E SYRIT (sh.shq.)
VARIOLË
SHKRIMTARI ALI .... / LLOJ KROKODILI
DISIPLINË SPORTIVE / AKTORJA ITALIANE ROSELLINI (shqip.)
BRITMË E LOPËS / AUTOMJETI
SOLISTJA QAZIMI
DUELI I BOKS GRIMCOVA (bised.)
SHTET (huaj) / PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE
PJESË E TULTË E TRUPIT / KRYEQYTETI I FILIPINEVE
KËNGËTARE E JONA
ZANORE
I TAKON BURRË I GUXIMSHËM
AJKA E QUMËSHTIT / DAULLJA
KËNGËTARE E VJETËR SHQIPTARE / UNIVERSITY LIMERICK ORCHESTRA
NJË PLANET
MASA NDËSHKIMO-RE (sh.shq.) / SHIU I IMËT
LLOJ GURI I ÇMUESHËM / BASHKËT.
FUTBOLLISTI ANGLEZ UEJN .... (MAN. UTD.) / BASHKËT.
ZANORE / TRAJNERI YNË VOKRRI
EPOKA E RE
KOMANDANT I NJË ANIJEJE
ZANORE QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE
MËDYSHJET / FAZA
FUTBOLLISTI STIVEN (EVERTON) / AFTËSI E PAGIMIT (treg.)
SUPER MODELJA AMERIKANE .... UPTON (orgj.)
LLOJ PEME (sh.shq.) / SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË
POEMË E VOGËL (shq.) / MODELJA KRASNIQI
NITROGJENI
SHPIRTI (Lat.)
AGIM TEJECI / ARTAN (perkdh.)
HAPËSIRË E CAKTUAR TERRITORIALE (shq.) / BASHKËT.
INDIUM / FUTBOLLISTI ITALIAN IGNAZIO (MILAN)
PARAKALIM USHTARAK (sh.shq.)
SHTET NË AZI / ISH FUTBOLLISTI KROAT .... TUDOR
ALUMIN / PËRKULJE NË NJËRËN ANË
KRYEQYTETI I PERUSË
IGLI TARE
EKSPOZITË E MADHE / AKTORJA & MODELJA ANGLEZE ... HURLEY
NAIM ISMAJLI / TRUP GJEOMETRIK
AZEM BEJTA / MENDIM
BASHKËT. / RINOR (perkdh.)
BASHKËT.
GABZHERR, GURMAZ / PAMELA ANDERSON
DRYNI / TEFIK OSMANI
EPOSI
ERMELINDA MEKSI / ZANORE
TRAJNERI GJERMAN REHAGEL / BASHKËT.
BOTIM
OJNA
MBRET ILIR
PËRSHËND-ETJE ALLATURKA

# SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | | | | | 1 | 4 | | 3 |
| | 1 | | | 2 | | | 9 | 7 |
| 2 | | | 8 | | | | | |
| 9 | | 3 | 1 | | 8 | | | |
| | | 4 | | | | 1 | | |
| | 7 | | 5 | | 2 | 9 | | 8 |
| | | | | | 6 | | 4 | 5 |
| 5 | 6 | | | | 3 | | 7 | |
| 3 | | 2 | 9 | | | | | |

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: MAKARA, OPOJA, NOTERI, NIKE, H, KAMINA, AL, KAP, BILATERAL, M, E PARA, ILIRI, FRE, UELLSI, LITERAR, LI, ALIU, KRIKET, MU, EMA, MEÇI, ETAT, MISH, GILI, I ZATET, MAZA, DËNIMET, ANITA TAKE, RIGA, RUBIN, RUNI, U, A, DILEMAT, PINAR, KATE, MOLLAT, BALADA, AZOTI, AT, ZONA, IN, PARADAT, OMANI, AL, IT, PANAIR, NI, AB, L, T, LARING, KATINARI, EPI, EM, OTO, EDITIM, NAZE, AGRON, TEMENA.

ZGJIDHJA E SUDOKUT: Kolona I:785 691 423; KII:416 325 897; KIII:239 874 516; KIV:923 168 754; KV:854 739 162; KVI:671 542 938; KVII:197 286 345; KVIII:568 413 279; KIX:342 957 681.

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Halit Geci"**
Komuna: **Skenderaj**
Data: **22.10.2018**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/112 - ESIP/SDG/112-CS/1.1** | Trajnim: **Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shkollës "Halit Geci" Llaushë, Skenderaj.**
Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës
Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:
Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie
Kualifikimet e firmës konsulente:
- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.
Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

**Kriteret e vlerësimit:**
- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Halit Geci" Llaushë, Skenderaj, më së largu deri më daten; 30.10. 2018.**
Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Shefshet Gecaj**
**Telefoni: 044/ 957-047**
**E-maili: sh.f.halit_geci@hotmail.com**

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Skënder Skënderi"**
Komuna: **Skenderaj**
Data: **22.10.2018**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/120 - ESIP/SDG/120-CS/1.2** | Trajnim: **Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shkollës "Skënder Skënderi" Vajnikë, Skenderaj.**
Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës
Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:
Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie
Kualifikimet e firmës konsulente:
- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.
Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;
Kriteret e vlerësimit:
- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Skënder Skënderi" Vajnikë, Skenderaj, më së largu deri më daten; 30.10. 2018.**
Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Halil Thaqi**
**Telefoni: 044/ 712- 641**
**E-maili: halilth@live.com**

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Malush Ahmeti"**
Komuna: **Skenderaj**
Data: **22.10.2018**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/117 - ESIP/SDG/117-CS/1.1** | Trajnim: **Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shkollës "Malush Ahmeti" Rezallë, Skenderaj.**
Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës
Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:
Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie
Kualifikimet e firmës konsulente:
- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.
Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;
Kriteret e vlerësimit:
- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Malush Ahmeti" Rezallë, Skenderaj, më së largu deri më daten; 30.10. 2018.**
Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Ismet Malaj**
**Telefoni: 044/ 747-485**
**E-maili: ismet_malaj@hotmail.com**

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Vëllezërit Frashëri"**
Komuna: **Skenderaj**
Data: **22.10.2018**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/121 - ESIP/SDG/121-CS/1.1** | Trajnim: **Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shkollës "Vëllezërit Frashëri" Qubrel, Skenderaj.**
Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës
Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:
Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie
Kualifikimet e firmës konsulente:
- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.
Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;
Kriteret e vlerësimit:
- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Vëllezërit Frashëri" Qubrel, Skenderaj, më së largu deri më daten; 30.10. 2018.**
Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Florim Rrustemi**
**Telefoni: 044/ 194 - 633**
**E-maili: florimrrustemi@live.com**

REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT

REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT

REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNIKA

ZYRA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## ANULON KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEDIT TË LIRA TË PUNËS:

**Te shpallur ne gazetën të datës: 17 tetor 2018 për:**

**I:**

**Titulli i vendit të punës:** **Drejtor i Departamentit të Informacionit dhe Komunikimi me Publikun**

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Kosova Arts Production” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: Nrb. Biznesit nr.fiskal: 600925145 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kosova Arts Production” D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit, broj fiskala: 600925145, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Kosova Arts Production “ L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: i number fiskal: 600925145, The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”



Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë

Eksperienca jonë - përfitimi i juaj.

Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
**Sektori i Personelit**

Nr.Ref. 2098/18, datë 22.10.2018.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit nga Komisioni përzgjedhës të datës 19.10.2018, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

**V E N D I M**
**Për përsëritje të Konkursit publik,**

I. Konkursi publik nr. 4841, datë 25.09.2018, për Zyrtar për Informim (1 pozitë) në Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, vazhdohet edhe për dy javë nga dita e publikimit në njërën nga mjetet e informimit.

II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;

III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Komisioni përzgjedhës sipas Vendimit nr. 4841/2 datë 27.09.2018, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit gjeti se për Zyrtar për Informim (1 pozitë) në Zyrën për Media dhe Mardhënie me Publikun, sipas këtij konkursi nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkohet që i njejti të vazhdohen sipas nenit 6, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procuedurave të Konkursit në Sektorin Publik, edhe 15 ditë, ku kërkohet plotësimi i dokumentacionit apo edhe kandidatë me përgatitje adekuate siç kërkohet në konkurs.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe rekomandimit në fjalë, lejon përsëritjen e Konkursit publik për Zyrtar për Informim (1 pozitë) në Zyrën për Media dhe Mardhënie me Publikun, edhe për dy javë.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET
- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Hasan Prishtina"**
Komuna: **Malishevë**
Data: **24.10.2018**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/150-ESIP/SDG/150-CS/1.2** | Trajnimi i mësimdhënëseve Vlerësimi Përmbledhës dhe Hartimi i Testit si Pjesë e Rëndësishme e tij (Klasat 1-9) |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës **"Hasan Prishtina" Terpezë – Malishevë.**

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimi i mësimdhënëseve Vlerësimi Përmbledhës dhe Hartimi i Testit si Pjesë e Rëndësishme e tij (Klasat 1-9)

**Kualifikimet e firmës konsulentë:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në vitin e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin arsimor
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Licenca e akreditimit për trajnimet e cekura.

Firmat konsulentë të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulentë duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën Trajnimi i mësimdhënëseve- Vlerësimi Përmbledhës dhe Hartimi i Testit si Pjesë e Rëndësishme e tij (Klasat 1-9)

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha trajnimi i mësimdhënësve (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve Vlerësimi Përmbledhës dhe Hartimi i Testit si Pjesë e Rëndësishme e tij (Klasat 1-9) (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

**Procesi i seleksionimit:**

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulentë te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulentë në adresën: SHFMU**"Hasan Prishtina" Terpezë – Malishevë.** më së largu deri më **1.11. 2018.**

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Emine Krasniqi,Telefoni: 044/652993, 049296845
E-maili: emi-2008@live.com

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
**Sektori i Personelit**

Ref. Br. 2098/18, data 22.10.2018.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, , članom 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, i Preporuka Komisije za izbor od 19.10.2018, Generalni Direktor SHSKUK-a izdao je sledeće:

**O D L U K A**
**Za ponavljanje javnog konkursa**

I. Javni Konkurs br. 4841, od 25.09.2018 god. za Službenika za Informisanje (1 mesto) u Kancelariji za Odnose s Javnošću i Odnose s javnošću, nastavlja se dve nedelje od dana objavljivanja u jednom od medija

II. Sektor kadrova je obavezan da izverši ovu Odluku;

III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

**O b r a z l o ž e n j e**

Komisija za izbor prema Odluci br. 4841/2 od 27.09.2018, tokom pregleda dokumentacije koja je utvrđena da za Službenika za Informacije (1 mesto) u Kancelariji za medije i odnose s javnošću, prema ovom konkursi nije ispunjavala uslove, isi se mora nastaviti prema članu 6 5.1 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o Regulativi postupaka nadmetanja za javne sektor, još 15 dana, gde je potrebno popunjavanje dokumentacije ili kandidata sa adekvatnom pripremom koja se traži na konkursu.

Stoga, Generalni Direktor UBKSK u skladu sa nadležnostima, u skladu sa važećim zakonom i dotičnom preporukom, dozvoljava ponavljanje javnog konkursa za Službeniku informaciji (1 položaj) Službenik za medije i odnose s javnošću za još dve nedelje

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
- * Kancelarija za kadrove,
- * Informacioni medij.
- * Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Blerta Perteshi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren

▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale ne parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

**Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë e përshtatshme dhe për banim kolektiv. Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.**

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

**Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëopia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.**


Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L